

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 10 PRILL 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

RISHI SUNAK: MIGRANTËT E PARË DREJT RUANDËS NË FUND TË PRANVERËS



PETRIT KUÇANA
**DREJTORËT
E BASHKISË
DHE INVESTITORËT
E DIASPORËS...**



ARBEN MANAJ
**KONSERVATORËT
PRANË HUMBJES!
THE TIMES: PARTIA
E SUNAK DO TË
MERRTE 100 DEPUTETË**

FUQIA E NJË LIBRI

DAUT DAUTI



"RILINDJA" E PIKTORIT, SHKOLLË PËR TRAJNIMIN E HAJDUTËVE

KIM MEHMETI



PUSHTETI QË ZBULON TË PRISHURIT QË NË VEZË!

IRENA BEQIRAJ



SPAK SI MAGAZINË FRUTA- PERIMESH

ARMAND SHKULLAKU



DY SFIDA PRANVERORE TË SERBISË


VETON SURROI



E ARDHMJA FILLON TANI

Dotech
websites

**JEPI FRYMËMARRJE
BIZNESIT TËND**



PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TE VINI NË
ZYRAT TONA

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545


The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Ka qenë goxha e përshtjelluar ideja e përcaktimit të investitorit strategjik. Madje duket se pikërisht ky përshtjellim ,ka qenë mbulesa perfekte e asaj që ndodhte ose po ndodh, përtej fasadës propagandistike.

Janë të paktën tre raste që lakuriqëzojnë çdo tentativë manipuluese për investitorët strategjikë.

Së pari ishte një i akuzuar nga drejtësia si pjesë e grupeve kriminale por që çuditërisht ishte bërë investitor strategjik në bregdetin verior të vendit.

Vazhdohet akoma me përdredhjet e ish-deputetit, pra burrit të ministres, që u zgjodh gjithashtu investitor strategjik, madje siç aludohet, duke përfituar në mënyrë të padrejtë edhe tokën e komshisë.

Madje besohet se burri i ministres, si investitor strategjik çoi në pranga edhe ish-kryetarin e bashkisë Himarë. Po të thella paskërkan qenë këto punë...

Rasti i fundit (që duket edhe më i pështiri) janë disa drejtorë të bashkisë së Tiranës, që jo vetëm krijuan kompani dhe merrnin vetë projekte miliona eurosh, (pra i caktonin vetë, i selektonin vetë, i mer-

rnin vetë).

Kaq brutalisht qenkerka vjedhur në Bashkinë e Tiranës?!

Sikur të mos mjaftonte kjo, këta tipat drejtorë, apo drejtorë të drejtorëve (firma quhej 5D) çuditërisht paskërkan marrë edhe statusin e investitorit strategjik në Durrës. Përparësitë e investitorit strategjik që nuk paguan taksa për 10 vite, nuk kishte sesi të mos përputheshin më drejtorët e bashkisë së Tiranës që janë pas hekurave. Dyshohet se miliona euro të përvetësuar (vjedhura) nga bashkia e Tiranës janë investuar në projektet strategjike të bregdetit.

Mbase nuk është shumë me vend që të pyetet edhe sa të tjerë mund të jenë, që nuk kanë rënë akoma në rrjetën e drejtësisë, por besohet se çdo qytetar shqiptar më banim jashtë republikës, mbetet i shokuar

nga bëmat e këtyre investitorëve strategjikë, e këtyre drejtorëve, që rezultojnë se kanë një pagë tejet modeste, diku 700 euro (pse marrin edhe rrogë?!)

Po sikur këta drejtorë të ishin nga diaspora?

Nga ata specialistët që drejtojnë apo menaxhojnë biznese dhe kompani me renome ndërkombëtare, që kanë dëshmuar aftësi të jashtëzakonshme drejtimi dhe menaxhimi? Shumë i mirë për të qenë e vërtetë...

Po përsenuk përfshihet Diaspora, qoftë edhe në investimet strategjike?

Nuk përzgjidhen, apo nuk qasen?

Ka një problem të madh; Nuk rekomandohen as nga patronazhistët as nga aktivistët, pra nuk do të mund të sjellin vota në sëndukun e partisë. Nëse do i referohehim kryeministrit, kur shprehej

se sistemi i bën njerëzit, mbetet tejet retorike çdoloj pyetje për sistemin. E madje madje do të shkohej edhe më tej tek vota e diasporës. Akoma nuk janë regjistruar shqiptarët e diasporës? Akoma nuk ka një listë të PHD-ve shqiptarë, pra doktorëve të shkencave?

Akoma nuk ka një listë biznesesh shqiptarët të diasporës?

Apo nëse këta do të vinin të investonin çdo të bëhej me pjestarët e krimit që gdhihen investitorë strategjikë, me burra apo gra ministrash, aq më keq me ata drejtorë që e kishin zët t'u merrte kush projekte tor i bënin vetë i përzgjidhnin vetë, i merrnin paratë vetë dhe gdhieheshin me kostumin e shtrenjtë të investitorit strategjik.

A mund të bëhet të paktën sa Kosova?

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER
SPONSORSHIP LICENSE

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Sipas tabloidit britanik "The Sun" me tirazh të madh dhe klikime të mëdha online, grupet kriminale shqiptare kanë vënë në objektivin e tyre, anglezët që janë në pritje të ëmbël, të cilat mund të jenë të gatshme të regjistrojnë emigrantët si babain e fëmijëve të tyre ende të palindur.

Reklammat në TikTok, synojnë gra dhe vajza angleze që janë të gatshme për të futur në certifikatat e lindjes së fëmijëve të tyre emigrantë të refuzuar, me qëllim shmangien e deportimit të tyre nga Britania, me argumentimin se

ata kanë të drejtë qëndrimi si e drejtë njerëzore e pasjes së familjes në Britani.

"The Sun" ka gjetur një reklamë në TikTok, e cila më pas është fshirë, e cila vetëquhej "Zyra Konsullore Londër".

Po ashtu The Sun shkruan se edhe në "Facebook" kanë gjetur një person në një faqe për shqiptarët në Britani, i cili kërkon të paraqitet si njerë, për të njëjtën arsye.

Një zëdhënës i Home Office tha se "Mashtrimi për çështjet e Imigracionit", duke përdorur certifikatë lindjeje false, është një



vepër penale serioze dhe kjo është arsyeja që ne kemi ndërmarrë masa për frenimin dhe zbulimin e tyre".

Këto vepra penale serioze nuk



bëhen pa pëlqimin dhe miratimin e nënave britanike dhe hetimi i "The Sun" nuk e përmend këtë fakt, si një palë në këtë tango penalisht të dënueshme. Lajmi vjen

në një kohë kur trysnia ndaj Sunakut për të frenuar kalimet ilegale dhe uljen e shifrave të emigrantëve të mbërritur në ishull, po shtohet së tepërmi, kur partia e tij do të testohet me shumë gjasa në tetor të këtij viti në zgjedhjet e reja parlamentare.

Çdo ditë po vijnë gomone nga Franca drejt brigjeve britanike, ku shifra zyrtare më e fundit është 5500 të mbërritur, mes tyre edhe shqiptarë.

Vetëm këtë vit, janë riatdhesuar në Shqipëri 700 shqiptarë, emigrantë dhe të dënuar. Ndërkohë, vetëm në 2023 mbërritën në Britani 13.714 shqiptarë.

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

Konservatorët britanikë të qendrës së djathtë në pushtet në Britani janë përballë humbjes elektorale më të madhe në histori, sipas sondazhit të sotëm të The Times të Londrës, ku ata mund të përfundojnë në zgjedhjet e këtij viti me afro 98 deputetë.

Aktualisht konservatorët në pushtet kanë 348 deputetë ose një shumicë prej 86 deputetësh, më shumë se opozita laburiste e qendrës së majtë.

Por nëse sondazhi do përkthehej në vota në zgjedhjet e reja që mendohet se do mbahen në vjeshtë, konservatorët do e pësojnë më keq se kurrë, madje më keq se në zgjedhjet e vitit 1906 kur ata kanë pasur rekordin më të ulët me 156 deputetë.

Edhe kryeministri Rishi Sunak rrezikon të mos fitojë në zonën e tij elektorale. Laburistët në zgjedhjet e ardhshme do arrijnë një fitore historike duke siguruar minimalisht një dekadë në pushtet me mbi 400 deputetë në parlamentin e ardhshëm.

Ka kohë që lajmet e zeza elektorale kanë nxitur spekulimet për zëvendësimin e Sunak përpara zgjedhjeve, lajme të cilat janë hedhur poshtë nga qeveria.



Ky lajm vjen njëkohësisht me një tjetër lajm të keq për qeverinë britanike për kalimet ilegale me gomone në La Mansh.

5000 emigrantë kanë kaluar me gomone në tremujorin e parë të 2024, ku 100

zgjedhjet e ardhshme

ARBEN MANAJ

KONSERVATORËT PRANË HUMBJES! THE TIMES: PARTIA E SUNAK DO TË MERRTE 100 DEPUTETË

gomone kanë mundur të kalojnë nga Franca drejt brigjeve angleze duke shënuar kalimin më të madh për një tremujor në histori, kur Britania i ka dhënë gjysmë miliardë sterlina Francës për të bashkëpunuar për frenimin e tyre.

Kjo në një kohë kur kryeministri Sunak kalimet ilegale i ka një nga prioritetet e tij, e në kushtet kur gjatë verës moti pritet të përmirësohet, kalimet gjithmonë janë shtuar.

Nëse ndodh që kalimet të rriten në muajt e pranverës dhe verës, ato do jenë një arsye më shumë që konservatorët të humbasin


GOLDFIELDSOLICITORSLLP

**41d Kilburn High Road
London NW6 5SB
Tel: 020 7372 1966**

We offer competitive prices for our range of services

Immigration & Nationality

Criminal Cases

Family Law

**Residential
Landlord
and Tenant & Commercial
Properties**



**Për më shumë informacione në
gjuhën shqipe kontaktoni Suelën
Mob: 07384295934**

DAUT DAUTI

‘The road to Mecca’ (Rruga për në Mekë), për herë të parë i botuar më 1954, është ndër librat më të lexuar të literaturës që ka të bëjë me Lindjen e Mesme. Libri është autobiografi e gazetarit hebre, Leopold Weiss, i cili pas konvertimit në mysliman njihet me emrin Muhamad Asad. Weiss apo Asad, ka lindur në vitin 1900 në Evropën Qendrore (Ukrainë), që atëherë ishte territor i Perandorisë Austro-Hungareze kurse ka vdekur më 1992 në Spanjë.

Pa asnjë dyshim ky është ndër librat më të mira të udhëpërshkrimeve që janë shkruar deri sot. Stili i shkrimit është brilant. Para se ta shkruante librin, autori për disa vite rresht është shquar në Perëndim duke qenë korrespondent i gazetës prestigjioze gjermane, Frankfurter Zeitung, nga Arabia Saudite, Palestina, Egjipti, Siria, Irani, Iraku, Afganistani, Pakistani, etj.

Për shkak se libri përmbanë edhe idetë e autorit për Lindjen e Mesme, Evropën dhe religjionin, sidomos Islam, është shndërruar në një vepër të rëndësishme të literaturës së këtij lloji. Është ndër librat e parë të shkruara nga një intelektual perëndimor për keqkuptimin që ekziston në Perëndim




për Lindjen, sidomos për botën arabe që është ndërtuar mbi bazat e kolonializmit. Libri përmbanë edhe aspekte historike, që nga familja Saud e deri te momenti kur Asad bëhet përfaqësues diplomatik i Pakistanit në OKB. Natyrisht, libri përmbanë edhe aspekte kritike për botën arabe. Me pak

fjalë, kjo është një vepër ndër më madhështoret të shek. XX, ku përshkruhet edhe transformimi intelektual dhe shpirtëror i njeriut. Libri është i konceptuar si një lloj mirazhi që autori e përjeton gjatë rrugës së tij të fundit për në Mekë në verën e vitit 1932, që zgjatë 23 ditë.

Bukuria e shkrimit të tij është aq e fuqishme dhe e thellë sa që pothuaj nuk ka lexues te i cili nuk ndërrohen disa perceptime për religjionin, kulturën,

rajonet gjeografike, që i ka pasur më herët në mendje.

FUQIA E NJË LIBRI





Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI SHQIPERI - ANGLI



SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh



BRITANI

Londër - Birmingham
Manchester - Leeds - Luton

NA KONTAKTONI

UK: 00447429200952

AL: 00355682948843

AL:00355694031009

TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI



+44 7741 588799



+355 67 728 2828

SHQIPËRI

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh
- Kuçovë
- Kozare
- Ura Vaigurore
- Korçe
- Pogradec
- Përrenjas
- Hollisht
- Peqin
- Rrogazhine
- Kavajë
- Durrës

ANGLI

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

Ju Faleminderit qe na besoni!

Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë

SUNAK DISKUTON ME PRESIDENTIN E RUANDËS, BRITANIA SYNON TË NISË DËBIMIN E AZILKËRKUESVE NË PRANVERË

Ndërsa BE-ja i ka kthyer sytë nga pakti Meloni-Rama për të mbështetur financiarisht ngritjen e kampeve të azilkërkuesve në shtetet ballkanike, britanikët këmbëngulin që ata të zhvendosen në kontinentin afrikan me fokus kryesor Ruandën.

Kryeministri Rishi Sunak priti në Doëning Street Presidentin e Ruandës Paul Kagame për t'i dhënë një frymë-marrje të re marrëveshjes për azilkërkuesit. Rishi Sunak pret që fluturimet me azilkërkues që do të dëbohen drejt Ruandës të nisen brena stinës së Pranverës.

“Këta azilkërkues mbërrijnë në Mbretërinë e Bashkuar me varka të vogla në kanal in e La Manshit. Diskutim skemat që do të thyen modelin e biznesit të bandave kriminale që rrezikojnë jetët në det”, tha Sunak

duke konfirmuar se e kishte përditësuar zotin Kagame për fazat e ardhshme të legjislacionit në parlament.

Planet e Sunak është përballur me një sërë pengesash në muajt e fundit, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, e cila në muajin Nëntor e konsideroi si të paligjshme marrëveshjen me Ruandën.

Gazetat britanike raportuan se shumica e godinave të banimit në Ruanda që ishin caktuar për azilkërkuesit u janë shitur blerësve vendas.



ata janë të gatshëm të presin në mënyrë të përsëritur mijëra azilkërkues që do të dëbohen nga Britania e Madhe.

Projektligji i qeverisë së Ruandës do të votohet në Parlamentin vendas javën e ardhshme kur deputetët të kthehen nga pushimet e Pashkëve.

Ish-Sekretarja e Brendshme britanike Suella Braverman tha se e vetmja mënyrë si të krijohet një efekt parandalues për të ndaluar njerëzit të hipin në varka dhe të vijnë në Mbretërinë e Bashkuar ilegalisht janë fluturimet e rregullta, me qindra pasagjerë që dërgohen rregullisht në Ruanda.

Kostoja e marrëveshjes me Ruandën mund të arrijë 500 milionë Paund. Siç e ka bërë të qartë qeveria e Ruandës,

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

The collage displays a variety of business cards for different construction and renovation companies. Each card includes contact information such as phone numbers, email addresses, and websites, along with a QR code for easy access. The companies listed include:

- FD CONSTRUCTION**: Over 18 years of experience in building and refurbishment work.
- LEO'S BAR & GRILL**: AUTHENTIC MEDITERRANEAN CUISINE.
- K ROOFING LTD**: NEW ROOF-LEAD WORK-FLAT ROOF. Exceptional results for our clients.
- E&G STEELFIXING**: ADDRESS: 33 CROMWELL CLOSE EAST FINCHLEY N20LL.
- TUSHA CONSTRUCTION**: THE BEST OF CONSTRUCTION. Redcar Road, Romford, England, RM3 9PX.
- B&B LONDON CONSTRUCTION LTD**: OUR SERVICES: Loft Conversion, Kitchen and Bathroom, Paving & Landscaping.
- A&D CONSTRUCTION LTD**: 751 Pauls Mews, Crawley RH10 1DR.
- JD CONTRACTORS**: We have more than 10 years of experience in the building industry.
- A&O SCAFFOLDING LTD**: Contact Us: Mob: 07552585665.
- OUR SERVICES**: CIVIL ENGINEERING & GROUNDWORKS, PAVING & LANDSCAPING, DRAINAGE, DRIVEWAYS & PATIOS, DEMOLITION.
- Our Services**: LOFT CONVERSION, EXTENSION, FULL REFURBISHMENT, PLUMBING & HEATING.
- Our Services**: Temporary Roof Systems, Gantry and Loading Bays, Painters Scaffolds, Access Towers, Chimney Stacks, Pavement Scaffolds, Birdcages, Internal High Status Scaffolds, Bricklayers Scaffolds.
- SERVICES: LALA SCAFFOLDING**: Temporary Roofs, Domestic Scaffolding, Industrial Access, Competitive Rates.
- B&B LANDSCAPE LTD**: 42 Devenay Rd, London, E15 4AY.
- ART CONSTRUCTION GROUP**: DREAM IT - REALISE IT - BUILD IT!
- ERK CONSTRUCTION**: Email: info@erkconstruction.co.uk, MOBILE: 07448607104.
- MR BUILDING SOLUTIONS**: YOU DREAM IT, WE BUILD IT! +44 7828 079908.
- Services**: LANDSCAPING, PAVING, DECKING, FENCING, BRICKS, SLABS, ARTIFICIAL TURF ETC.
- LALA SCAFFOLDING LTD**: Southern Arsenal Road Harnchurch, Essex RM11 3BQ.
- OUR SERVICES**: REFURBISHMENT, EXTENSIONS & LOFT CONVERSIONS, GROUNDWORKS & FOUNDATIONS, METAL WORK, FILING, PAINTING & DECORATING, CARPENTRY, ELECTRICAL & PLUMBING, PAVING & LANDSCAPING, ROOFING, KITCHEN, BRICKLAYING, STEELFIXING.

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ

ARMAND SHKULLAKU

RAMA-VELIAJ, KËTA SHENJTORË QË PO TRADHËTOHEN NGA DISHEPUJT E TYRE

Reagimi kryeministrit dhe kryetarit të Bashkisë së Tiranës, në lidhje me korrupsionin e frikshëm në qeverisjen e kryeqytetit, tregon se krerët e organizatës së Rilindjes kanë arritur në pikën ku nuk iu bëhet më vonë se sa të besueshëm mund të jenë në justifikimin e tyre dhe se çfarë mund të mendojnë ata që i votojnë. Rama dhe Veliaj këpusin të njëjtat kopaçe, pa e vrarë mendjen se qytetarët nuk janë dele që mund të përtypin broçkullat e tyre të pafajësisë, ndërsa sistemi i kalbur i një qeverisje mafioze është i qartë për të gjithë.

Nëse dikur Rilindja ishte përpjekur ta ruante një farë cipe të asaj që quhet përgjegjësi politike, tashmë ajo ka plasur fare. Pasi kanë bërë për budallenj “heronjtë” e SPAK-ut (kuptohet me dëshirën e plotë të tyre) Rama e Veliaj po i marrin dhe shqiptarët për budallenj me argumentin se “ç’punë kemi ne, me çfarë bëhet poshtë nesh”.

Çështja është se në këtë vend të vogël, si prokurorët e SPAK ashtu dhe çdo qytetar i thjeshtë, e ka të qartë skemën me të cilën operon organizata e Rilindjes. Qindra milionë euro që rrjedhin nga tendera, koncesione e PPP dhe shkojnë për të pasuruar disa, për t’u përdorur në zgjedhje, për të blerë media e gazetarë, nuk lëvizin nga inisiativa e disa individëve që abuzojnë me postin, por janë mekanizmi, i cili garanton pushtetin e kupolës së Rilindjes.

Do të mjaftonte një logjikë fare e thjeshtë për të kuptuar se përse fjalimet patetike të Ramës apo Veliajt janë qesharake dhe nuk bindin askënd. Si njëri dhe tjetri nuk u gjenden përballë një skandali që shpërtheu papritur. Ata nuk u kapën në befasi nga një skemë e fshehtë dhe e sofistikuar korrupsioni, që vartësit e tyre kishin thurrur në konspiracion të plotë. Si në rastin e skandaleve të qeverisë, ashtu dhe në ato të bashkisë, prej vitësh ishte dhënë alarmi nga



Kontrolli i Lartë i Shtetit, opozita dhe media se miliona euro po abuzoheshin hapur ditën për ditë. Por askush nuk mori mundimin t’i verifikojë këto akuza, madje përkundrazi bënë avokatinë e tyre, sepse sistemi dhe organizata nuk duhej të dekurajoheshin. Ndërsa kur ndonjë prej ushtarëve të Rilindjes binte në rrjetën e drejtësisë, formula magjike ishte: Partia Socialiste nuk është zyrë avokatie.

Mbledhja e asamblesë së PS tek inceneratori i Elbasanit, shëtitja e kryeministrit nëpër studio televizive e spitale me bisturi në dorë, mbrojtja publike nga Veliaj e drejtorëve që bënë tendera për kompaninë e tyre, ishin pikërisht strategjia për t’u dhënë zemër atyre që “vjedhin Shqipërinë për të vjedhur vota dhe vjedhin vota për të vjedhur Shqipërinë”. Përndryshe si mund të shpjegohet që kryeministri dhe kryebashkiaku, këta njerëz të punës dhe me shije të lartë, nuk pyetën kush ishin biznes-

menët që do të menaxhonin dhjetra milionë euro nga buxheti i një vendi të varfër.

Si ka mundësi që një projekt që shkonte deri në 430 milion euro (inceneratorët) iu besua disa individëve pa emër e përvojë në këtë fushë? Si doli një murator nga Italia që fitoi besimin e liderit sqimatar për koncesionin e sterilizimit apo një bukëpjekës i ngratë që mposhti gjithë kompanitë e mëdha për të trimfuar në tenderat disa milionëshe të Bashkisë? A nuk u befaskan ata njëherë të vetme për këtë sukses të papritur të shtresës modeste të shoqërisë që do habiste dhe baballarët e ekonomisë së tregut?

Mirë Edi Rama, se ndoshta në atë kohë ka patur halle shumë më të mëdha mbi supe si fjala vjen kriza në Bjellorosi apo pajtimi i Greqisë me Turqinë, po ky i bashkisë si nuk e takoi njëherë bukëpjekësin për ta reklamuar si model sukcesi të njeriut të punës?

Gjithësesi, Rama dhe Veliaj mund të thonë përsëri se ç’punë kanë ata se si prokurohen paratë publike, kush i merr dhe ku i çon. Prokurorët e SPAK mund të jenë të kënaqur me këtë shpjegim, por qytetarët sigurisht që nuk janë dele. Nëse dikur jepej 20 përqindshi si tarifë korrupsioni për tenderimet publike, Rilindja e ka çuar nivelin ma nalt: krijon kompanitë e veta për ta marrë të plotë llokmën nga taksat e qytetarëve. Nëse dikur bëheshin manovrimet me letra për të përcaktuar një garë, tani privati merr kodet e komisionit të vlerësimit për të hyrë vetë në procedurë e për t’u vetëshpallur fitues. Por përsëri udhëheqësit nuk kanë asnjë përgjegjësi.

Rama nuk ka përgjegjësi që ministrat hanë mollë e dardha.

Zëvendëskryeministrja nuk ndjen asnjë barrë faji që drejtori i saj më i rëndësishëm i çonte paratë publike te kompania e tij. Ky i bashkisë është krenar që nuk ka ditur gjë që milionat e buxhetit shkonin tek biznesi i drejtorëve të tij.

A mund të quhet shtet ky? Në mos për përgjegjësinë penale, por për atë politike, a do duhej të paktën të kërkonin falje dhe të ishin kokëulur?

T’ia faturosh rënien e shtetit disa vartësve, që janë thjesht ekzekutorët e organizatës, nuk është turp vetëm për ata që e bëjnë, por edhe për prokurorët e SPAK dhe për të gjithë ata që bëjnë sikur e besojnë.

Është njësoj sikur një kumbar i mafias, që ndan punët dhe drejton organizatën, kur i kapen ushtarët, të dalë të thotë se përgjegjësia është individuale, se ai respekton ligjin dhe punon në shërbim të komunitetit. Këtu kemi arritur dhe s’kemi parë gjë akoma.

NUMRI I TË RINJVE U UL ME SHPEJTËSI NGA 2019-2023, POR ATA NË KËRKIM TË PUNËS U RRI TËN

MONITOR

Nga viti 2019 deri në 2023, numri i të rinjve 15-29 vjeç ra me 94 mijë, ose me 13.7%, por nga ana tjetër, numri i të rinjve që kërkojnë punë është rritur. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, në vitin 2019, kishte 681,552 persona të moshës 15-29 vjeç, teksa në zyrat e punës ishin të regjistruar si punëkërkes 15,372 persona. Në tremujorin e fundit të vitit 2023, popullsia e moshës 15-29 vjeç ishte 587,888 persona, ndërsa mbi 17,880

të rinj ishin të regjistruar në zyrat e punës si të papunë, ose 16% më shumë se në 2019.

Ndonëse tregu i punës vitet e fundit ka raportuar mungesa punonjësish në të gjithë aktivitetet, papunësia e të rinjve po vjen gjithnjë e në rritje. Madje vitet e fundit, edhe në sektorin publik që dikur ishte shumë i kërkuar, ka shumë vende të lira, sidomos në qarqe. Ekspertët e tregut të punës analizojnë se rritja e papunësisë te të rinjtë vjen si mospërputhje e ofertës për punë dhe kërkesës që kanë të rinjtë.

Viti pas viti, arsimi në vendin tonë ka humbur lidhjen me tregun e punës dhe modelin e zhvillimit. Të rinjtë e arsimuar kanë pak sektorë ku mund të angazhohen, teksa ekonomia është përqendruar në sektorë që kërkojnë krahepunë, të tillë si punonjësit e shërbimeve, ndërtimit dhe fasonit. Pas pandemisë, prirja e papunësisë ka shënuar rritje te të rinjtë. Në tremujorin e fundit të vitit 2020, papunësia në grupmoshën 15-29 vjeç ishte 21,7%, ndërsa në tremujorin e fundit të vitit të kaluar arriti në 22%.

Krahasimet tregojnë se edhe në kulmin e pandemisë, kur papunësia e përgjithshme u rrit, papunësia e të rinjve është më e butë se aktualisht. Anketat e tjera që kanë matur emigracionin potencial, kanë treguar se vështirësitë në punësimin e të rinjve janë shkaktari kryesor për emigrimin e tyre. Gati 80% e personave që largohen nga vendi janë të rinj nën 30 vjeç dhe arsytet e largimit lidhen me përpjekjet për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike.

Të dhënat tregojnë se të rinjtë kanë më shumë vështirësi për të gjetur

punë në krahasim me grupmoshat e tjera në moshë pune. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është 22,0% më 2023. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2022, shkalla e papunësisë për të rinjtë, është rritur me 0,6 pikë përqindje, ndërsa krahasuar me tremujorin e tretë 2023, ky tregues është ulur me 0,02 pikë përqindje. Për grupmoshën 30-64 vjeç, shkalla e papunësisë ishte 7,9% në tremujorin e fundit 2023. Në terma vjetorë, ky tregues është rritur me 0,3 pikë përqindje dhe krahasuar me tremujorin e mëparshëm ka një rritje me 0,4 pikë përqindje./Monitor

OLA XAMA

Ajo që lexohet në dosjen e hetimeve të SPAK për aferën e kompanisë ‘5D Konstruktion’, nuk është as më pak e as më shumë se ato që dëgjojmë çdo ditë për mënyrën se si paracaktohen tenderat dhe se si shteti vendos kë të bëjë të pasur duke blerë pushtet. Duke kontrolluar në procedurat e prokurimeve që i janë dhënë kësaj firme, në total të dalin një dizinë kompanish të cilat marrin pjesë në tendera herë bashkë dhe herë kundër njëri-tjetrit. Përfituesit numërohen me gishtat e dorës dhe ata që nuk janë rrethi i tyre skualifikohen në të gjitha fazat.

Çudia që na krijuan hetimet e kompanisë 5D, lidhet me risinë se në dalim nga skema klasike që kemi dëgjuar, drejtorët nuk merrnin përqindje në tendera por ia çonin të gjitha paratë firmës së tyre. Është naive që çdokush në këtë vend të besojë se ata që sot punojnë në poste drejtuese në administratë rropaten për të mirën e popullit, dalin lypin vota ditë e natë në fushatë dhe kënaqen me një pagë që në rastin më të mirë nuk kalon 1.200 euro. Me pagat që sot ka shumica e institucioneve publike, ai që kërkon të pasurohet me dinjitet ose kalon në sektorin privat ose largohet nga ky vend.

Naive është po ashtu të besohet se kryebashkiaku Erion Veliaj nuk ka

VELIAJ NË RASTIN MË TË KEQ BASHKËPUNËTOR, NË MË TË MIRIN I PAAFTË



ditur gjë për këtë aferë. Përgjegjësia e parë ka të bëjë me rolin e tij si titullar i Autoritetit Kontraktor në 8 procedura ku fitues ka qënë kompania ‘5D Konstruktion’. SPAK ka vërtetuar se pronarë janë drejtorët më të rëndësishëm të Bashkisë Tiranë dhe njerzit

e afërt të tij. A duhet hetuar nëse ka patur dijeni për konfliktin e interesit, njësoj siç është hetuar roli i ish-ministrit Ilir Beqaj te dosja e ‘Sterilizimit’?

Së dyti, titullari i Autoritetit Kontrak-

tor është personi i cili cakton njësinë e prokurimit, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, shpall fituesin dhe lidh kontratën. Po ashtu, në 3 raste Erion Veliaj është njoftuar me shkresë nga operatorët pjesëmarrës në tender për ankesa që kanë patur për

skualifikim të padrejtë.

Natyrshtëm lind pyetja: A është Erion Veliaj ai që lexon ankesën dhe cakton antarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave? Si ka vepruar ai në rastin që disa kompani e kanë njoftuar se oferta e tyre më e ulët, që mund t’i kursente para bashkisë dhe qytetarëve është skualifikuar padrejtësisht? Përse komisioni i ankesave i ngritur prej tij, nuk konstatoi shkeljet që gjeti SPAK në këto procedura?

Përgjegjësia e tretë është morale. Përse Veliaj nxitoi të mbështesë drejtorët e tij dhe të ‘duartrokasë’ kallëzimin që ata bënë për shpifje pas denoncimit të kandidatit të PD në zgjedhjet lokale? Përse nuk ngriti një audit, nuk ushtroi një kontroll, nuk premtoi hetime? Këtë histori sido që ta kthesh, të gjitha rrugët të çojnë te konkluzioni se ose përfitimet e paligjshme janë bërë me bekimin e tij, ose institucioni që ai drejton ka rënë në të gjitha instancat. Në rastin më të keq është bashkëpunëtor dhe në rastin më të mirë është i paaftë për të drejtuar bashkinë!

XHERLADIN ZENELI

Të mërkurën, me 27 Mars 2024 në Komisionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit për politikën dhe demokracinë, është aprovuar raporti i cili rekomandon dhe njëkohësisht i hap rrugën anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës. Raporti u votua me 31 vota pro, 4 kundër dhe 1 abstenim.

Në befasi të askujt, kundër këtij raporti votuan 2 përfaqësues të Serbisë, përfaqësuesi i Bosnjë e Hercegovinës dhe i Malit të Zi. Me vendimin e tyre, Serbia përmes Aleksander Vuçiqit dhe Bosnja e Hercegovina përmes presidentit të Republikës Serbe, Milorod Dodik, arritën të ndikojnë që edhe përfaqësuesi i Malit të Zi t’ju bashkangjitet vendimit të tyre kundër Kosovës.

Që nga formimi i qeverisë së re të Malit të Zi në Tetor të vitit 2023, qeveri kjo e dalur nga zgjedhjet parlamentare të muajit Qershor e të njëjtit vit, me të drejtë është folur shumë për elementet pro serbe dhe pro ruse që ishin bërë pjesë përbërëse e këtij pushteti.

Pjesë e koalicionit aktual të qeverisë së Malit të Zi janë edhe dy subjektet politike shqiptare: koalicioni “Forumi Shqiptar” dhe koalicioni “Aleanca Shqiptare”.

(Për hir të korrektësisë, vlen të për-

A DUHEN TË TËRHIQEN SUBJEKTET POLITIKE SHQIPTARE NGA KOALICIONI QEVERITAR NË MAL TË ZI?

mendat këtu se Lidhja Demokratike në Mal të Zi, u tërhoq nga koalicioni qeverisës në momentin kur kryetar i Kuvendit u zgjodh Andrija Mandiq dhe që nga atëherë nuk është pjesë e koalicionit të partive shqiptare “Aleanca Shqiptare”).

Ishin pra prezencat e këtyre elementeve pro-serbe me sentimentin anti-Kosovë që me rastin e formimit të qeverisë së re nxiti reagime dhe shqetësime në opinionin shqiptar lidhur me pjesëmarrjen e këtyre dy subjekteve politike shqiptare në këtë qeveri.

Shqetësimet e atëhershme u dëshmuar si të vërteta me votimin e përfaqësuesit të Malit të Zi kundër raportit i cili i jep Kosovës dritën e gjelbërt në rrugën drejt anëtarësimit e saj në Këshillin e Evropës, ditën e Mërkurë, me 27 Mars 2024.

Të mos përmendim këtu edhe vizitën që pak kohë më parë, Milorod Dodik i bëri kryetarit të Kuvendit të Malit të



Zi, Andrija Mandiq, në Podgoricë. Rikujtojmë se në marrëveshjen e koalicionit qeverisës, e arritur me rastin e formimit të qeverisë në Tetor të vitit të kaluar, pjesë e së cilës janë edhe dy subjektet e lartpërmenduar politike shqiptare në mes tjerash, thuhet:

“Qeveria do të mbetet e përkushtuar për harmonizimin e plotë me politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së, duke respektuar të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e marra ndërkombë-

tarisht. Kjo duhet të garantojë se Qeveria nuk do të marrë vendime që do të vënë në pikëpyetje pavarësinë e Kosovës...”

Shihet qartas që erdhi deri te cenimi i marrëveshjes paraprake në mes të subjekteve politike shqiptare të cilat ndajnë pushtetin me qeverinë aktuale lidhur me mos ndryshimin e politikës së jashtme të Malit të Zi, posaçërisht asaj në raport me Kosovën.

Vertetë që pati reagime deklarative

nga disa përfaqësues shqiptarë lidhur me votën ‘kundër’ nga ana e përfaqësuesit të Malit të Zi ndaj hapjes së rrugës për Kosovën në Këshillin e Evropës, por sa do të kenë efekt këto deklarata në rishqyrtimin e këtij vendimi skandaloz për Malin e Zi, mbetet të shihet.

Por, nga perspektiva e faktorit politik shqiptar mos respektimi i marrëveshjes duhet të jetë një kërcnim serioz i besimit të tyre ndaj kësaj qeverie.

Prandaj, unë mendoj se se nuk mjaftojnë vetëm deklaratat kritikuuese të përfaqësuesve politik të shqiptarëve ndaj vendimit të përfaqësuesit të Malit të Zi kundër Kosovës, por ata duhen ta konsiderojnë edhe terheqjen nga koalicioni qeveritar me qëllim që t’ju dërgohet një mesazh i qartë qeverisë së tanishme të këtij shteti se ata, pra subjektet dhe përfaqësuesit politik të shqiptarëve në Mal të Zi, nuk do të tolerojnë të kenë kthim mrapa kur bëhet fjalë për çështjen e shtetësisë së Kosovës dhe nuk do të lejojnë në asnjë mënyrë të pengohet integrimi i Kosovës në organizatat euro-atlantike.

ARMAND SHKULLAKU

SPAK SI MAGAZINË FRUTA-PERIMESH

Si për ironi të fatit, një nga drejtorët e arrestuar të Bashkisë Tiranë, ka mbiemrin Molla. Sikur të mos mjaftonin provat e shumta që dëshmojnë kontrollin e pushtetit mbi SPAK, ky institucion që u ngrit pikërisht për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivele të larta, po kthehet në një magazinë fruta-perimesh. Deri tani, në të gjitha rastet, prokurorët specialë nuk kanë shkuar dot më larg se sa akuzat ndaj atyre që kanë dardha e mollë pas shpinës së shefave të mëdhenj.

Rasti i kriminalizimit të administratës më të lartë të Bashkisë së Tiranës, është një tjetër provë për të parë nëse këtë herë “heronjtë e drejtësisë së re” do të guxojnë ta nxjerrin këmbën nga rrethi. Në të kundërtën do të shndërrohen në anekdotë, që nga misionarë përfunduan në kopshtarë të oborrit të pushtetit.

Në aferat më skandaloze të qeverisë Rama, SPAK nuk tentoi kurrë të hetojë procedurat që çuan në abuzime të frikshme si ato të inceneratorëve, konçensioneve në shëndetësi apo tjetërsimeve të pronës publike. Prokurorët u mjaftuan me bishtat fundorë për të evituar kupolën e organizatës kriminale të Rilindjes. Shprehja e Edi Ramës për ata që mbledhin dardha e mollë pas shpinës së tij, ishte si një formulë magjike që SPAK t’ia vinte vetes me ndërjegje kufirin të thana.

Mirëpo, drejtësia e re nuk do duhej ta



kishte raportin me pushtetin, por me publikun, interesin dhe paratë e të cilit ka marrë përsipër të mbrojë. Nëse pas shpinës së kryeministrit ka ministra që mbledhin fruta pa leje, nëse pa shpinës së ministrave ka drejtorë që mbllaçisin po ashtu fruta pa leje, kur kjo filozofi aplikohet edhe në bashkinë më të madhe të vendit, atëherë ky nuk është më problem i pushtetit, por i drejtësisë që ose i merr shqiptarët për budallenj ose përfundimisht i ka dorëzuar armët tek ata që kontrollojnë qindra milionë euro, me të cilat janë të aftë të blejnë gjithçka e këdo. Sepse fabulën e ujit që buron i kulluar por turbullohet rugës, sot nuk ka njeri që mund ta përtypë më.

A mund ta besojë dikush që disa ministra u mblodhën në fshetësi dhe ia hodhën kryeministrit me një projekt

që shkonte deri në 430 milion euro? Që ata bënë të gjitha procedurat në kohë rekord, zgjodhën një kompani pa pikë përvojë, dhanë leje e miratuan vendime dhe ky i shkreti, i vuajtur nga dëshira për ta parë Shqipërinë e pastër, hodhi firmën fap e fap, vktimë e naivitetit dhe mirëbesimit tek njerëzit që varen prej tij?

Deri më tani, SPAK, duke i vënë kapak aferës së inceneratorëve, po dëshmon se e beson rrëfimin e ujit të kulluar. Problemi është se ky rrëfim po kthehet në pandemi që ka pllakosur gjithë Rilindjen. Ministrat në detyrë nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për drejtorët e tyre më të rëndësishëm që kapen me presh në duar. Kryetari i Bashkisë ndihet i qetë, kur gjithë struktura e lartë nën drejtimin e tij del e kriminalizuar. Me logjikën ç’punë kam unë me ata që vjedhin poshtë

meje, mund të shtyjnë ditët përgjegjësit e vërtetë, por jo SPAK.

Prokurorët nuk janë alienë që jetojnë në një planet tjetër. Ata e dinë, kanë dokumente, informacione, komunikime, që një batërdi e tillë 10 vjeçare nuk është vepër e mbledhëse të mollëve e dardhave

Nuk janë ata që ndajnë plaçkën e pushtetit, që përzgjedhin kompanitë zhvatëse të parasë publike, që ngrënë shtabet elektorale për të blerë vota, që paguajnë mediat dhe gazetarët e propagandës, që derdhen miliona te lobistët, që vënë kompasin mbi hartat e pronave dhe që së fundi bëjnë edhe regjinë e drejtësisë së re. Një kriminalizim të tillë, asnjë budalla nuk ua faturon dot disa drejtorëve bedelë, in-granazhe të mjera të një makinerie mjeshttrash pushteti.

Nëse SPAK u ngrit për të luftuar krimin e organizuar, sot nuk ka organizatë më kriminale se sa Rilindja që përvetësimin e parave të qytetarëve e bën hapur dhe me arrogancën e një pushteti të pacënuar.

Emrat e ushtarëve të organizatës që sfilojnë para drejtësisë së re, janë statistika që shërbejnë për të kamufluar kupolën, që SPAK nuk merr kurajon t’i afrohet. Cila kompani mund të fitonte miliona euro në Bashkinë e Tiranës, vetëm me ndërhyrjen e dytre drejtorëve? Si mund të depërtonte një person privat në sistemin që përcakton kriteret e tenderimeve dhe të shpallte veten fitues? Ku përfundonin milionat që u grabitëshin sistematikisht qytetarëve?

SPAK sigurisht që i di përgjigjet e këtyre pyetjeve. Duke mos jetuar në një planet tjetër, por këtu ku jetojnë të gjithë, prokurorët janë të qartë se si funksionon organizata kriminale. Se si përdoren këto miliona në fushata elektorale, në investime me emra të fshehur, në shoqëri fiktive që sot kontrollojnë çdo qelizë të tregut gjoja të lirë.

Çështja nuk është tek padija, sepse kupola as merr mundimin të fshijë gjurmët, por tek vullneti i prokurorëve të SPAK.

Do të tentojnë të justifikojnë besimin që një pjesë naive ende ka, apo do të përfundojnë në një magazinë fruta-perimesh, duke pritur që ca mollë e dardha do të teprojnë edhe për ta. /Lapsi.al/

ALFRED LELA

JUSTICIALISMI: DREJTËSI E RE APO DREJTËSI E RILINDUR?

Skandali i radhës-janë bërë aq të shumtë sa nuk i lënë as radhë njërit-tjetrit-, zbuloi të njëjtin problem sistematik, si në qeveri ashtu edhe në bashkinë më të madhe në vend që drejtohet nga Erion Veliaj.

Një duzinë drejtorësh të lartë, të grumbulluar rreth një korporate private-bashkiake të emërtuar 5D, shërbenin si manovratorë të aktiviteteve të dyshimta në qeverinë e Tiranës.

Për krahasim, mund të thuhet se, siç ka rënë qeveria pas implikimit në korrupsion të disa ministrave, edhe bashkia ra, pikërisht nëpërmjet rënies së ‘ministrave’ të saj, drejtorë të lartë. E gjithë kjo që ndodh risjell, për të satën herë në ligjëratën publike, qëndrimin e qeverisë dhe bashkisë, të pagëzuar në shkrime të mërpashme si justicialismo. Përmbledhtazi, ky term shenjon këmbimin e qeverisjes politike, pas rënies së saj qoftë edhe simbolike, me një lloj të ri governance ku prin drejtësia me aparatit e saj të prokurori-gjykatave.

Tek dëgjoje kryebashkiakun Veliaj të përballej, më në fund, me trysinë publike ndaj përfshirjes së bashkëpunëtorëve të afërt në korrupsion të dyshuar, të vriste veshin pikërisht

siht ky ‘dorëzim’ i çelsave të publikes te një trupë për të cilën shqiptarët nuk votojnë, drejtësia.

Po ta përqendrosh ligjëratën e Ramës dhe Veliajt në një frazë të shkurtër do të ishte ‘ne vjedhim, por drejtësia është e fortë’.

Ky është, pra, justicialismi dhe është i rrezikshëm fort.

Së pari, sepse nuk kryen atë që demokracitë parlamentare kanë në themel, ndarjen e pushteteve, por mbivendos një pushtet kundër tjetrit, sipas nevojave të çastit. Në këtë rast ekzekutivi është i lumtur të qeverisë pa ndërprerje duke lëshuar në gollët e drejtësisë disa eksponentë të saj. Kjo duket si rivendikim i publikut-ata vjedhin, por edhe dënohen-, por çka nuk prodhon



është përgjegjësia. Ku është përgjegjësia politike në këtë rast? Kush e mban? Kush e reflekton?

Së dyti, politika, nëpërmjet qeverisë dhe bashkisë, nuk mund t’u nxjerrë përpara votuesve shqiptarë drejtësinë si mburojë. Sikur për asgjë tjetër, për atë se në Shqipëri, ndryshe nga sa në

Amerikë, nuk votohet drejtpërdrejt për prokurorët dhe gjykatësit. Pra, nuk lahen duart e Ponc Pilatit qeverisës duke thënë se e zgjidh trupa juridike hebreje dënimin e Krishtit, se nuk është çështje e Romës politike, por punë banditësh dhe gjykatash.

Kjo bëhet, sigurisht, për të zhveshur qeverinë/bashkinë nga përgjegjësitë dhe për ta zhvendosur debatin publik drejt gërmushjeve të tipit “Krishti apo Baraba?”. Në fund shpëton Baraba, sigurisht, edhe pse në këtë lojë tonë nuk asnjë Krisht.

Duhet shtuar se, drejtësisë së re i shkon për shtat ky shtet i ri jolegjitim i bazuar në justicialismo, qoftë edhe për faktin banal se i motivon të kërko-

jnë rritje rrogash dhe benefite të tjera nga qeveria (siç edhe kanë bërë). Pa harruar idealizimin e tyre nëpërmjet sondazhesh që heroizojnë ata dhe ndihmojnë qeverinë.

Ky pakt mefistofelian mes qeverisë dhe drejtësisë, për të lejuar një justicialismo ad hoc zhbën përpjekjet shtetndërtuese të 32 viteve e disa qeverive. Ekzekutivi nuk mund të fshihet pas gjyqësorit dhe as të zgjidhë kriza politike nëpërmjet tij. Gjyqësori nuk mund të luajë rolin e parzmores së qeverisë, duke ruajtur krerët e saj dhe duke rrokullisur ‘koka turku’. Kush i prin fushatave politike duhet ta mbajë edhe barrën e fajit për ekipin që ndërton dhe zgjedh për të qeverisur pas fitores.

Futja e drejtësisë në mes kësaj aksiome demokratike, publikut dhe interesit të tij, është asgjë më pak se trupa juridike që ekzekutojnë Krishtin dhe lë në qarkullim Barabën (Krishti në këtë rast është një sistem i drejtë i shtetit ligjor dhe demokratik)./POLITIKO

Dotech
website

Porosisini BANNERIN TUAJ

**Me përmasa
të ndryshme
PVC Banners
Mesh Banners
Ofsted Banners
Design + Post**



**TRANSFORMING
SPACES & CREATING
DREAMS**

LEADERS IN
CONSTRUCTION



Our service :

- Loft Conversion
- Extension
- Kitchen & Bathroom Refurbishment
- Plumbing
- Heating
- Electricals

☎ 07479611186 🌐 www.impresseurope.co.uk

☎ 07733025619 ✉ info@impresseurope.co.uk

Për çdo konsultim mund të vini në zyrat tona

Adresa e zyrove:

30 Avenons Road London E13 8HT

Tel: 020 7018 7929

Mob: 073 4066 5946. Mob: 078 5997 7545



DISTRICT

CONSTRUCTION

Services

DESIGN & BUILD
LOFT CONVERSION & EXTENSION
KITCHEN RENOVATION
BATHROOM RENOVATION
REFURBISHMENT
ROOFING
GARDENING
PLUMBING & ELECTRICALS
PAINTING & DECORATING



www.districtconstruction.co.uk

info@districtconstruction.co.uk

Tel: 07780941795

KIM MEHMETI

“RILINDJA” E PIKTORIT, SHKOLLË PËR TRAJNIMIN E HAJDUTËVE

Në Shqipëri thuhet nuk kalon java e ndonjë funksionar i saj të mos akuzohet për hajdutëri. Kështu që ke përshypjen se "Rilindja" e Piktorit është shkollë për trajnim të hajdutëve. Së fundmi, mediat lajmëruan për arrestimin dhe ngritjen e akuzave për hajni kundër disa drejtorëve të Bashkisë së Tiranës. Me çka të duket se Lali Eri ka vendosur t'i largojë nga kursi i hajdutërisë të gjithë të paafët dhe ata t'i zëvendësoj me hajna më të shkathët. Sidoqoftë Shqipëria vazhdon të mbetet shembull shkollaresk se asnjë popull dhe asnjë shtet nuk është aq i varfër sa burrëshetësit e tij hajdutë të mos kenë çka të vjedhin e nga çka të pasurohen. Pastaj Shqipëria vazhdon të jetë pasqyrë ku shpërfaqet e vërteta se një shtet e një popull nuk e demtojnë



gjithaq burrëshetësin e tij hajdut, sa nga hajdutëria e mbulojnë hajninë. është biznesi më fitimprurës, andaj mediat dhe elitat e tjera që ushqehen Shqipëria është shtet ku hajdutëria shumëkush e vlerëson se më mirë të

bie të shkosh disa vjet në burg si hajdut i pasur i "Rilindjes", sesa në kurbet ku do kalbesh duke punuar e do të djegësh malli për të afërmit. Po pra, në Shqipëri nuk kalon java pa u përhapur lajmi për zbulimin e ndonjë funksionari hajdut të "Rilindjes". Me çka s'ke si mos mendosh se mëmëdheun e kanë në duar ata që i përmbahen mendësisë komuniste se kapitalizmi qëndron mbi shtyllat e zhatjes së popullit dhe vendit që drejton.

Dhe mbase andaj, tani për tani, Shqipëria ka vetëm një elitë të konsoliduar e të fuqishme, atë të hajdutëve, elitë që i mirëmban, i ushqen dhe i kontrollon të gjitha të tjerat, të cilat janë po aq mëkatore dhe të dëmshme për popullin sa edhe ajo hajdutokrate.

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:
020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

The collage displays a variety of business cards from different companies, including:

- FD CONSTRUCTION**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. Contact: 020 7470 8222.
- LEO'S BAR & GRILL**: AUTHENTIC MEDITERRANEAN CUISINE. Contact: 020 3788 7119.
- K ROOFING LTD**: NEW ROOF-LEAD WORK-FLAT ROOF. Contact: 07927 214785 / 07477 867732.
- E&G STEELFIXING**: ADDRESS: 31 CROMWELL CLOSE EAST FINCHLEY ROAD. Contact: 07585 575280.
- TUSHA CONSTRUCTION**: THE BEST OF CONSTRUCTION. Contact: 07492 248409.
- B&B LONDON CONSTRUCTION LTD**: More information: 0800248752.
- OUR SERVICES**: Over 18 years of experience in building and refurbishment works. Includes New Build, Loft Conversion, Extension, Kitchen and Bathroom, Paving & Landscaping.
- WE OFFER**: New Work, Lead Work, Flat Torch Roofing Systems, Liquid Roofing Systems, New Gutter, New Fascia & Soffit Roofing.
- Services**: Concrete Structures, Columns & Wall, Concrete Slabs, Steel Fixing, Fabricated Mesh, Ground Beams.
- OUR SERVICES**: Loft Extension, Refurbishment, General Building Work.
- OUR SERVICES**: CIVIL ENGINEERING & GROUNDWORKS, PAVING & LANDSCAPING, DRAINAGE, DRIVEWAYS & PATIOS, DEMOLITION.
- Our Services**: LOFT CONVERSION, EXTENSION, FULL REFURBISHMENT, PLUMBING & HEATING.
- Our Services**: Temporary Roof Systems, Gentry's and Loading Bays, Painters scaffolds, Access Towers, Chimney Stacks, Pavement Scaffolds, Birdcages, Internal High Status Scaffolds, Bricklayers Scaffolds.
- Services**: Temporary Roofs, Domestic Scaffolding, Industrial Access, Competitive Rates, Professional and experienced Scaffolders, Personalised services, All scaffolding work undertaken.
- BKB LANDSCAPE LTD**: 42 Devenay Rd, London, E15 4AY. Contact: 07450211425 / 07727635228.
- MR CONSTRUCTION GROUP**: DISCOVER THE QUALITY. MANAGER: M. ROXHURS: 07476768895. DIRECTOR: P. OMERI: 07521731006.
- Services**: EXTENSIONS, KITCHEN & BATHROOM RENOVATING, ELECTRICALS, PLUMBING & HEATING, COFFER BEAMS, SALOONS, RESTAURANTS.
- Services**: LANDSCAPING, PAVING, DECKING, FENCING, BRICKS, SLABS, ARTIFICIAL TURF ETC.
- LALA SCAFFOLDING LTD**: 9 Southend Arment Road Harchurch. Contact: 02021 129374.
- OUR SERVICES**: REFURBISHMENT, EXTENSIONS & LOFT CONVERSIONS, GROUNDWORKS & FOUNDATIONS, ROOFING, PAINTING & DECORATING, CARPENTRY, ELECTRICALS & PLUMBING, PAVING & LANDSCAPING, ROOFING, BRICKLAYING, STEELFIXING.

PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD, LONDON, E13 8HT

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



KLODIAN TOMORRI

Një njeri me NIPT hap fjalë se po merr leje për një projekt ndërtimi. Mjafton vetëm kaq dhe fillon të arkëtojë para nga qytetarë, të cilët nxitojnë të prenotojnë banesa për të përfutur çmime okazion.

Shitja e banesave pa filluan ende puna në kantier është një fenomen, që po përhapet me ritme të frikshme së fundmi. Nëse kësaj i shton dhe zgjerimin e pandalshëm të sektorit të ndër-

NEVOJA URGJENTE PËR TË MBROJTUR QYTETARËT NGA SHITJA E HIÇIT

timit, përfundimi është i qartë. Qytetarët shqiptarë po ekspozohen masivisht para riskut të mashtrimit.

Në të gjithë këtë marrëzi, ka një pyetje që lind natyrshëm. Çfarë ndodh me qytetarët nëse dikush që ka arkëtuar paratë e tyre duke u shitur ajrin, zhduket? Ose e lë në mes pallatin? Ligjërisht asgjë. Sot Shqipëria nuk ka asnjë ligj, që të mbrojë qytetarin nga mashtrimi. Ndaj kjo ndërhyrje është bërë e domosdoshme dhe urgjente.

Shqipëria nuk ka nevojë të shpikë apo të bëjë ndonjë gjë të jashtëzakonshme. Mjafton të kopjojë modelet e vendeve të tjera. Disa prej tyre kanë të sanksionuar me ligj se ndërtuesi nuk mund të përdorë asnjë qindarkë nga paratë e arkëtuara për një projekt banimi në aktivitete të tjera, pa mbyl-

lur më parë detyrimet kontraktuale për përfundimin e objektit.

Të tjerë, si Maqedonia e Veriut i detyrojnë kompanitë e ndërtimit që të ngrijnë në një llogari të posaçme es-croë, të paktën 20 për qind të arkëtimeve nga prenotimet e apartamenteve.

Masat që mbrojnë qytetarët nga mashtrimi i shitjes së hiçit nuk kanë dalë nga hiçi. Por kanë ardhur pas eksperiencave të dhimbshme. Sot Shqipëria rrezikon shumë të përballet me të tilla eksperiencia.

Zgjerimi i pandalshëm i ndërtimit dhe shitjet e ajrit nuk janë faktorët e vetëm të riskut.

Ka dhe një faktor tjetër, por aq shqet-

sues. Ky është ai që ka të bëjë me stofin e investitorëve në ndërtim.

Nëse deri pak vite më parë, kompanitë e ndërtimit në Shqipëri numëroheshin me gishtat e dorës dhe ishin aktorë të besuar në treg, tani në këtë sektor mund të gjejmë çfarëdo. Banditë, trafikantë, mashtrues dhe kontigjente të tjera nga bota e kimit. Mjafton vetëm një NIPT.

Përtej kësaj, janë dhe investitorët nga jashtë. Supozoni vetëm një moment skenarin e një investitori të huaj që shet ajër në Shqipëri dhe pasi ka transferuar paratë jashtë vendos të largohet edhe vet. Çfarë e pengon për shembull Mohammed Alabbarin ta

bëjë këtë? Pra, që pasi ka shitur ajër

pa leje ndërtimi në Durrës, të largohet së bashku me paratë e qytetarëve.

Dikush dhe qeveria mund të thonë se zoti Alabbar është një nga investitorët më seriozë në botë në këtë sektor. Kjo mund të jetë e vërtetë. Por shteti nuk i mbron qytetarët me emrin e mirë. Sepse po të ishte ashtu, ndërtuesi më i madh sot në botë duhet të ishte Papa i Romës.

Qeveritë i mbrojnë qytetarët e tyre me ligje. Nëse ato rrinë duarkryq kur risqet formësohen, atëherë fatura që vjen pas është e rëndë. Dhe sot në sektorin e ndërtimit risqet po ndërtohen me shpejtësi. Shitje në ajër, investitorë të huaj, banditë dhe të fortë me leje ndërtimi. Ky është terreni pjellor i hatasë.

FRANO KULLI

Ende sot mbasi kanë kaluar tetëdhjetë vjet han prap hamendësime pjesmarja e Ernest Koliqit në qeverinë e Shevqet Vërlacit (21 prill 1939 - 3 dhjetor 1941). Koliqi, njëri prej shkrimtarëve dhe intelektualëve më në zë të Shqipërisë së kohës u përfshi në një qeveri "të përbërë nga njerëz pa vlera të veçanta", siç pohon studiuesi dhe historiani Berndt Fischer. Sikurse ende përmendet si e dhënë gojore edhe një bisedë e Koliqit, rrethanë e momentit kur ai ftohet në Tiranë për t'i propozuar postin e ministrit. Është viti 1939 ai kishte pak kohë që ishte emëruar titullar i Katedrës së Gjuhës dhe letërsisë Shqipe në Universitetin "La Sapienza" në Romë. Sipas gojëdhënës, Koliqi nuk e jep përnjiherë pëlqimin, por kërkon pak ditë kohë. Prej atje kthen në Shkodër e takon... At Gjergj Fishten.


-Më kanë propozue me u ba ministër i arsimit, pader...

-Me u ba minister - ia kthen pader Gjergji, pa pritë shpjegime më të gjata prej bashkëfolësit.

-Po, unë s'kam mujt me e dhanë fjalën, për pa u pá e me fol me ty, pader - kërkon të shtjellojë kërkesen e vet Koliqi më parë se t'ia merrte mendimin atij që e çmonte aq shumë.

-Po pra po, me u bá minister - ia kthen me këmbëngulje pader Gjergji e i thotë prerë argumentin e vet- se të tanë tjerët e bajnë ma keq se ti... (O Zot çfarë kut vlerësimi për vlerat kishin njerëzit si ata. Me një ekzigjencë shembullore për dijet e për punët në dobi të saj e të kombit). Dhe Ernest Koliqi, kështu u bë ministër i shtetit për arsimin. Ministri me gjurmën më të dukëshme e të dobishme në arsimin e shqiptarëve... Sapo filloi punën në këtë detyrë, ai mblodhi

DYQIND ARSIMTARËT E ERNEST KOLIQIT NË KOSOVË



reth vetes njerëzit e kulturës, shkrimtarët më të shquar dhe filloi përpilimin dhe botimin e teksteve shkollore. Si Ministër i Arsimit në shtatorin e vitit 1941 ai mundësoi me një vendim që mbi 200 arsimtarë normalistë, të shkonin në Kosovë dhe në trojet shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi. Pa u caktuar ende formula me të cilën Kosova do t'i kthehej Shqipërisë dhe pa ardhur ende udhëzimet nga Roma, nën përgjegjësinë personale, Ministri i Arsimit, Prof. Ernest Koliqi nisi drejt "tokave të lirueme" 200 mësues e profesorë me synimin e qartë të vendosjes së themeleve të arsimit

shqiptar. Një akt i tillë ka qenë dhe mbetet përjetësisht një nga aktet më sublimë sepse ai dha frutet e veta në hapjen e shkollave shqipe, në rrënjosjen e dëshirës për të mësuar shqipen në të gjithë trojet shqiptare.

Prej shtetit të brishtë shqiptar, ende pa u formësuar mirë si i tillë shkoi ndër mend dhe e bëri punë të kryer dërgimin te vëllezërit e një gjaku atë për atë çfarë ishte më e nevojshme atje. Dërgoi mësues për të dhënë dije atje, duke plotësuar kështu të nxëniet e të mësuarit shqip si nevojë jetikë për ruajtjen e identitetit kombëtar, të shqiptarëve të atjeshëm që historia e

padrejtë i kishte shkëputë prej trugut të kombit e dheut amë.

Në vijim të asaj ç'ka nisi ministri Koliqi, "në vitin 1943, pa u mbushur dy vjet, në Kosovë dhe në vise të tjera shqiptare në Maqedoni dhe Mal të Zi u hapën dhe punonin 511 shkolla fillore shqipe me 19 121 nxënës, të cilët i mësonin dhe edukonin drejt kombëtarisht 487 mësues (prej tyre 78 mësuese)... Ernest Koliqi kontribuoi edhe në hapjen e Normales së plotë në Prishtinë, në hapjen e Liceut në Prizren dhe Tetovë, në hapjen e Shkollës Normale në Gjakovë, të in-

stitutit Teknik Bujqësor dhe Gjimnazit në Pejë".

Në një letër dërguar më 16 tetor 1941 nga ministri i arsimit të Qeverisë së atëhershme shqiptare Ernest Koliqi konsullit shqiptar Kolë Rrota në Vjenë thuhet se ka angazhuar Norbert Joklin si organizator të bibliotekave të Shqipërisë me një rrogë mujore prej 600 frangash ari...). Edhe si arsye madhore për ta shpëtuar albanologun e shkëlqyer hebre nga kthetrat e nazistëve.

Qeveria e Shqipërisë 4 vjet më parë, ministrin e arsimit e kishte nga Kosova. Nuk e di se për ç'potenciale publike e punë të mirë mund të përmendet zonja. Përveçse si përzgjedhje kinse patriotike e kryeministrit, Zotit Rama në sinkron me mblodhjet e përbashkëta të atyre kohëve, të dy qeverive, tashmë të harruara, vendimet e të cilave u "shkruan në akull". Dhe po të sjellësh ndër mend "shown" e atëhershëm ndjen neveri prej fall-sitetit. Si për shumë gjëra të tjera të shpeshta, kësso dore... Për traun e rrugës së kombit a për a për taksën e shtrenjtë të mallrave që qarkullojnë nëpër të ndërmjet dy popullatave shqiptare andej e këndej. Apo për taksën e shtrenjtë të librave 6%, (edhe të librit shqip, sigurisht) më të shtrenjtën në rajon.

Kurse po t'i krahasosh punët e ministrin së vitit 2019 me ministrin Ernest Koliqi, të vitit 1941...fyen rëndë historinë...

ERVIN HATIBI

PARADOKSE PADREJTËSIE ME BARAZINË DHE DHIMBJEN

Të shpërndarë me vrap në drejtime të ndryshme, lëkurëkuqët transportuan buzëqeshjen e tyre plot ligësi në pasqyrëzat që ua morën paftyrësisht për një dy xhingla-mingla ari safi njerëzve të bardhë, kurse këta derëbardhët po ashtu shikonin se si ngërdheshja e tyre konkave bëhej edhe më konvekse ose, anasjelltas, në totemthat apo byzylykët e artë, që paftyrësisht për më pak se hiçgjë ua morën paganëve në shkëmbim të ca pasqyrave të krisura xhepi.

Gjithkush ishte i kënaqur dhe mua ty gjithkush mashtrues, dhe hajde ta mirëmbash dot kënaqësinë, se mashtrimi i tjetrit bëhet vrasje ndërgjegjeje, pastaj vuajtje dhe tjetër punë sesi u pa më vonë ky transakcion në manualët e NAFTA-s (North American Free Trade Assh.); shkëmbimi funksionoi dhe gjithkush ishte ekonomikisht i kënaqur, sidomos për sa kohë që pasqyrat në lëkurëkuqërinë amerindiane ishin padyshim miliarda herë më të rralla sesa ari në vendet nga vinin pasqyrat dhe mbase anasjelltas. (Domethënë, më shumë kishte ar në Spanjë se pasqyra në Bolivi dhe më shumë ar në Bolivi sesa pasqyra në Spanjë. Po u desh që të lindte Bolivari, Simoni, që të kuptohej kjo). Nuk qe pra shkëmbim, por shkërbim. Megjithëse mbetet shkëmbim.

Sa i përket shkëmbimit të vuajtjes, ai bëhet i vërtetë vetëm në bazë të bujarisë. Në momentin ku dihet botërisht se askush nuk mund të vuajë sa dikush dhe, anasjelltas, të gjitha palët e përfshira në shkëmbim duhet ta flenë mendjen se përherë dikush vuan më shumë, po ec ta gjes se kush është ky se! Dhe, a i hyn në punë gjallë në botë dikujt që vuan fakti se dikush vuaka më shumë... kështu që thjesht duhet pranuar ai qelqi me oksid në një faqe, e në faqen tjetër si këmbim do dhënë patjetër floriri i paramenduar. Për sa kohë që të gjithë jemi e do mbetemi kontinente mesjetarë, të gjitha shkëmbimet që ndodhin



natyrshëm kanë vlerë reale, pavarësisht faktit se ç'mund të shkruajnë me ironi apo dhimbje orientaliste njëra palë për tjetrën, shekuj më pas.

Mungesa e sinqeritetit i kthen shkëmbimet në shkërbime, se po të kishte pasur kurajën ai amerindiani që krejt lakuriq e pa u skuqur nga turpi t'i thosh të bardhit: "O vëlla, më ndje se po bëj padrejtësi që po të marr këtë copë zhgëndërr llamburitëse (pasqyrën) duke të ngarkuar si gomari me gjithë këto xhingla mingla floriri të cilat na janë mbushur tezgat e ambulanteve"; dhe, po të kishte pasur po ashtu mirësinë marinarin t'i thoshte vendaliut se jo vetëm që po i jepte diçka që nuk i duhej (keni parë ndonjë marinar të krehur?) në këmbim të një thesari, po gjithashtu nuk po i hiqte sytë në asnjë çast transakcionit edhe nga busti i gruas së vendaliut (shiko sa bukur: lakuriqësia e lëkurëkuqeve kryesisht qëndron në faktin se ata janë

të kuq edhe kur nga turpi janë skuqur për shkërbimin e shkëmbimit nuk u ka lëvizur fare lakmushi: imagjino ekuivalenti spanjoll, sikur largqoftë të ishte lakuriq, se si do ishte përprushur nga turpi deri në kërcinj. Le që do ta kishte djegur dielli para turpit. Ama për sa kohë që kishte edhe mjekër mesjetare, nga turpi dhe dielli thjesht mollëzat i janë puhitur ca me të kuq, e aq dukje nga gjithë ai ajsberg i përgjakur turpi që fshihte nën rrobat e lirisë si prushi poshtë hirit.)

Dhe, gjithë ajo që na hyn në punë tani, është pasoja, prapaskena e transakcionit ose prapaskena e shkërbimit të shkëmbimit. Imagjino dhimbjen e indigjenit sapo kthehet në shtëpi dhe sheh mu në korridor sa hyn statujëzën e perëndisë fisnore, që e pret prej disa orësh me një vështrim të ashpë r. (Bile, meqë ka katër kokë, vështrimet janë më shumë, e të gjitha kërcënojnë). Ai e ka bërë shkëljen e madhe:

ka mashtruar e grabitur mysafirin. I prihen gjunjët dhe bie duke qarë përpara stokut të pasqyrave që e dëshmojnë apo përpilojnë, shumëfishuar, bashkë me ato kokat kritike përmbi dhe nis e ha brenda e pendesa dhe pasqyrëzat mbyten në lotë disafish dhe përjetohet dhimbja.

Imagjino tani marinarin që kthehet duke brohoritur në latinishte vulgare, kurse grushtet plot të florinjta i tringëllojnë me piksama të buta kukurisje sit ë kishte në duar ndonjë çupëlinë, dhe sa ngjitet në anije, sa kapërcen rrotullat me litarë kërpi të kripur e thasët me pataten e porsazbuluar të kuzhinës, shtynë me bërryla derën e dhomëzës, dhe hedh thesarin në shtrat... e frenon përmbi statujëza e të kryqëzuarit që mirëmban ditë-natë aty një dhimbje e një siklet si vrasje këpucësh tendosur pafuqishëm në dhomën kutërbonjëse, dhe nis e qan marinarin dhe gjunjëzohet nën

vështrimin plagosës të kryqëtores dhe minjtë me skorbut i lëvrijnë në prehrin me ar fajtor e patate zhvarrosur. Dhe nis i dhemb për padrejtësinë.

Në këtë moment zbulojmë se bashkë me shkëmbimin e njëmendtë të ngazëllimit të floririt me ngazëllimin e pasqyrimit johidrik të marinës spanjolle, i cili shkëmbim u shoqërua me shkërbimin e pretendimeve për njëvlefshmëri të arit banal me të cilin ishin mbushur përrenjtë rrëzë Andeve me pasqyrat po aq banale, bile më pak, me të cilat qenë mbushur punëtoritë e Flandrës dhe Venedikut dhe tregjet e gjithë lagjes, bashkë me përputhjen e vizionit të të bardhit për të pronësuar me ar një copë botë Brenda pasqyrës, bashkë me këtë shkëmbim-tari të ndërlikueshme, më në fund fare vjen vrasje e ndërgjegjeje edhe shkëmbimi mekanik i dhimbjes, por jo të bashkëjetuar. Askush nuk e di se ndodhi, as sa.

Gjithkush është i dobët për sa është njeri, dhe gjithkush rreket t'ia hedhë gjithkujt duke kërkuar t'i jepet vlera e panjohur e tjetrit në këmbim të pavlerës së mirënjohur të vet; puna është se edhe ai tjetri bën të njëjtën gjë, si zakonisht. Që të mos ketë shkërbim po shkëmbim, pa pasur nevojë për dordolecë e autoportrete qepe që i kemi humanizuar të na humanizojnë nga altari, skena të na bëjnë të qajmë, e thjesht duhet kujtuar se automatikisht jemi njerëz dhe çfarëdo që të japim dhe çfarëdo që të na japin për të do të jetë thjesht e pakryer e paplotë e paarrirë; dhimbje pra? Patjetër. Ama kjo na fut në një diskutim akoma më të gjatë për durimin, alkimia e të cilit e kthen në as pasqyrën e dhimbjes, etj., etj... (marrë nga revista "Medius")

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

E nesërmja fillon tani!

Dotech
websites 

Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini
në çdo kohë në zyrat tona

Dotech
websites 

Na kontaktoni:
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



Akoma nuk keni një website?

MUND TE VINI NË ÇDO KOHE NË ZYRAT TONA

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

- ✓ BUSINESS CARDS
- ✓ BANNERS
- ✓ LOGO
- ✓ POSTERS
- ✓ VIDEO MARKETING

The Albanian

OFERTA
SPECIALE

Dotech
websites 

KONTAKTONI

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



BAZAT SERBE NË KUFIN ME KOSOVËN NË FORMË PATKOI

Përpara se policia kosovare të fillojë patrullimin e saj në kufirin me Serbinë, ata e ngarkojnë makinën me armatim: AK-47 janë të lidhur në pjesën e pasme të sediljeve të veturës, pistoletat poshtw këmbëve dhe dronët dhe jelekët antiplumb të mbushur në bagazhin e Land Rover.

Ky është tani protokoll standard në një nga kufijtë më të paqëndrueshëm në kontinentin evropian.

Kur njerëzit e pyesin Venton Elshanin, zëvendëskomandantin e policisë në veri të Kosovës se si është situata, ai thjesht u tregon përgatitjet që bën para patrullimit. “I shihni armët?” tha ai, para se ta nxirrte grupin e xhirimit të Telegrafit në kufi, “këto janë për t’i mbajtur policët. Situata nuk është e mirë.”

Që kur Kosova fitoi pavarësinë nga Jugosllavia në një luftë që përfundoi në vitin 1999, ajo ka pritur një komunitet të vogël serbësh etnikë në rajonin kufitar verior. Tensionet me shumicën etnike shqiptare janë rritur së fundmi. Aleksandër Vuçiq, presidenti i Serbisë, ka lënë të kuptohet për një pushtim. Nacionalistët i kërkojnë atij që të veprojnë për të “mbrojtur” serbët e detyruar të jetojnë nën “sundimin” kosovar.

Frika e një lufte të re u rrit në vitin 2023 kur një grup i armatosur serbësh sulmuan përtej kufirit në fshatin verior të Banjskës dhe u barrikaduan në manastirin e tij. Tre nga 30 militantë të dyshuar u vranë në një shkëmbim zjarri. Një nga njerëzit e komandant Elshanit humbi jetën në shkëmbim zjarri.


Që nga ajo ditë, oficeri dhe ekipi i tij kanë kryer patrulla ditore në rajonin kufitar të dominuar nga serbët, duke kërkuar rrugë të paligjshme në Serbi të llojit të përdorur nga personat e armatosur në sulmin e tyre.

“Ne i njohim këto rrugë më mirë se kushdo,” tha komandanti Elshani për The Telegraph ndërsa patrulla përshkoi rrugën e saj nëpër male. “Serbët nuk mund të shkojnë asnjë rrugë që ne nuk do ta gjejmë.”

Në numërimin e fundit, policia identifikoi 65 rrugë të paligjshme, të gjitha të bllokuara me kanale të mëdha të prera në beton. Edhe 10 rrugë të tjera mbahen nën vëzhgim të vazhdueshëm, kryesisht nëpërmjet dronëve.

Prezenca e vazhdueshme në rajonin me shumicë serbe i dërgoi mesazh Beogradit se Kosova po i mbronte kufijtë e saj, tha komandanti Elshani.

“Banjska ndryshoi lojën, e vendosi lojën në një nivel tjetër për shkak të



vdekjeve,” tha ai. “Kur gjaku derdhet, atëherë është problem.”

Patrullë e ushtarëve amerikanë në kufirin mes Kosovës dhe Serbisë
Patrullë e ushtarëve amerikanë në kufirin mes Kosovës dhe Serbisë
Komandant Major Gjeneral Özkan Ulutaş, i forcave paqeruajtëse të Nato-s në Prishtinë
Komandant Major Gjeneral Özkan Ulutaş, i forcave paqeruajtëse të Nato-s në Prishtinë
Analistët paralajmërojnë se propaganda e Kremlinit po nxit trazira në veri në një komb ku 93 për qind janë shqiptarë dhe 4 për qind serbë. Shumica e serbëve në Kosovë ende e konsiderojnë Beogradin, i cili kurrë nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, si qeverinë e tyre.

Pas rrethimit, autoritetet zbuluan një depo të madhe armësh që sulmuesit kishin fshehur në ndërtesat e papërdorura përreth fshatrave veriore. Vetëm pak javë më parë ata zbuluan pesë raketahedhës të tjerë, një shenjë e shkallës së sulmit të planifikuar.

Në një intervistë për The Telegraph, Albin Kurti, kryeministri i Kosovës, paralajmëroi se zoti Vuçiq, presidenti i Serbisë, kishte në plan të pushtonte. Ai tha se Serbia kishte

ndërtuar baza operative përpara rreth kufirit në një “formë patkoi” për të “mbrojtur Beogradin dhe sulmuar Kosovën”.

48 bazat ushtarake që Serbia ka ngritur në kufi me Kosovën në formën e një patkoi
48 bazat ushtarake që Serbia ka ngritur në kufi me Kosovën në formën e një patkoi
Shpërqëndrimi nga lufta në Ukrainë
Bazuar në fjalët e vetë presidentit Vuçiq, Kurti beson se presidenti serb po kërkon kohën e tij për një mundësi për të pushtuar.

Miqësia e Vuçiqit me Vladimir Putinin është e njohur dhe Kurti beson se është në interesin e liderit rus që Serbia të pushtojë Kosovën, pasi kjo do të largonte vëmendjen nga lufta e tij në Ukrainë.

Pas Urës së Mitrovicës që ngrihet mbi lumin Ibër, flamuri i Serbisë i kuq, i bardhë dhe blu valëvitet gjithandej. Dikur kjo urë ishte një “pikë e nxehtë” – një ndarje joformale midis rajonit kufitar verior të Kosovës dhe jugut etnik shqiptar. Gjërat duken paqësore, ndërsa këmbësorët ecin lirshëm midis dy anëve.

Por ka tension nwn kwtw panoramw. Disa banorë etnikë serbë

nga veriu e shohin këdo që kalon në jug si tradhtar, një njeri që tradhton plagët e pashëruara nga gjakderdhja e viteve 1990.

Policë të Kosovës në kufi me Kosovës, përmbi fshatin e Banjskës. Një prej tyre thotë se situata nuk është e mirë
Policë të Kosovës në kufi me Kosovës, përmbi fshatin e Banjskës. Një prej tyre thotë se situata nuk është e mirë
Makinat ende nuk lejohen të kalojnë mbi urën, e penguar nga bllokada dhe prania 24/7 e dy policëve me Land Rover, njëri i parkuar me pamje nga jugu dhe tjetri nga veriu.

Policia tha se këto masa paraprake ishin thelbësore për të ruajtur stabilitetin në zonë.

Thashethemet flasin se Putini ka rekrutuar serbë për të luftuar në ushtrinë e tij kundër Ukrainës dhe ndërsa The Telegraph udhëtonte në veri, solidariteti me Rusinë ishte i gjithëpranishëm. Shkronja “Z” ishte grafituar në anët e dyqaneve, kafeneve dhe shtëpive lokale.

Albin Kurti thotë: “Kjo është pishina nga ku ata [Rusia] do të rekrutojnë paraushtarakë të ardhshëm të Wagner-it për Ukrainën

dhe Ballkanin”.

Në një tabelë rrugore, dikush kishte shkruar fjalët “F— k Nato”, një paralajmërim për praninë paqeruajtëse të bllokut të KFOR-it, i cili është stacionuar në Kosovë që nga viti 1999.

Ashtu si policia, ata kryejnë patrullime, duke vigjiluar në atë që e quajnë si vijë kufitare administrative, një shtrirje tokësore prej 237 miljesh që ndan Kosovën dhe Serbinë.

Togeri i parë Caldwell i Gardës Kombëtare të Gjeorgjisë, i cili përbën kontributin e Amerikës në KFOR, tha se detyra e tyre ishte të zbulonin këdo që synonte të ndiqte veprimtari armiqësore.

Ai theksoi rëndësinë e “ndërprerjes” së rrugëve ilegale për të ndaluar kalimin e kontrabandistëve në Kosovë. Sipas tij më shumë ndërprerje rrugësh po kryheshin sa herë që ishte e mundur. Për komandant Elshanin njerëzit e tij janë në stërvitje për sulm.

“Nuk është surprizë që Vuçiq dëshiron të pushtojë,” tha ai. “Ata mund të na qëllojnë, por nuk mund të na trembin.”/ The Telegraph, përshtati Lapsi.al

WILLIAMS: BEOGRADI DUHET TË ZGJEDHË MES PERËNDIMIT DHE RUSISË

Paul Williams, profesor i Universitetit Amerikan në Uashington dhe ekspert i së drejtës ndërkombëtare, beson se vendimi i Listës Serbe për të bojkotuar votimet për shkarkimin e kryetarëve në katër komunat në veri të Kosovës, bie ndesh me interesat e qytetarëve serbë në Kosovë. Prof. Williams vlerëson se procesi i normalizimit ka ngecur sepse Serbia refuzon faktin që Kosova është e pavarur dhe shkaktim provokime dhe pengesa, përfshirë së fundmi përpjekjet për të bllokuar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Në një intervistë për Zërin e Amerikës, Prof. Williams, thotë se amerikanët dhe evropianët duhet t'ia bëjnë të qartë Serbisë se duhet të zgjedhë mes Perëndimit dhe Rusisë. 25 vjet pas ndërhyrjes së NATO-s prof. Williams, i cili ishte këshilltar për delegacionin e Kosovës në Rambuje, në bisedën me kolegen Keida Kostreci, e cilëson Kosovën një histori të madhe suksesi, pasi me atë ndërhyrje u ndërpreu mizoritë dhe u shpëtua e ardhmja e saj, por edhe sepse SHBA mësoi vlerën e ndërhyrjes humanitare dhe mbrojtjes së aleatëve dhe miqve të saj.

Nga Kedia Kostreci

Zëri i Amerikës: Profesor Williams, Lista Serbe vendosi të mos marrë pjesë në votimet për shkarkimin e kryetarëve të katër komunave në veri të Kosovës, për t'u hapur rrugën zgjedhjeve të reja. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian e kritikuan këtë vendim. Cili është mendimi juaj për këtë qëndrim nga ana e subjektit kryesor politik të serbëve të Kosovës?

Paul Williams: Është një zhgënjim i vërtetë që Lista Serbe ka vendosur sërish të bojkotojë votimet. Ka kaluar një çerek shekulli tashmë që Kosova ka qenë e pavarur dhe në rrugëtimin drejt demokracisë, funksionimit të shtetit ligjor. Dhe kjo taktikë e bojkotimit të votimeve demokratike nuk është një mënyrë serioze për të mbrojtur interesat e shtetasve serbë të Kosovës. Kosova ka demonstruar aftësitë e saj për t'iu përmbajtur shtetit ligjor, për të patur zgjedhje demokratike. Sinqerisht ka ardhur koha që drejtuesit e serbëve në Kosovë të përqafojnë plotësisht demokracinë, ashtu siç angazhohen të gjithë të tjerët në Evropë në procesin politik.


Zëri i Amerikës: Ky është vetëm ndërlidhimi i fundit që nuk është i lidhur vetëm me veriun, por në përgjithësi me procesin e ngecur të normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë. Në fakt, i dërguari i BE-së, Miroslav Lajčak, duke komentuar mbi këtë proces tha se palët nuk janë të gatshme për normalizim. Çfarë faktorësh ndikojnë sipas jush tek kjo mungesë vullneti për të respektuar marrëveshjet e vitit të kaluar dhe për të ecur përpara me normalizimin?

Paul Williams: Mendoj se është e

rëndësishme të mos ndiqet versioni i Bashkimit Evropian apo i Serbisë, sipas të cilit të dyja palët janë përgjegjëse, se është një ngurrim i dyanshëm. Sinqerisht, sa herë bëhet përparim drejt normalizimit, Serbia do ta ngacmojë Kosovën, ose do të krijojë një provokim në mënyrë që të mund të thotë 'shikoni, qeveria kosovare nuk është dhe aq e interesuar për këtë normalizim siç jemi ne'. Mendoj se Serbia nuk ka arritur ta kuptojë se Kosova nuk është më pjesë e Serbisë, se është një vend i pavarur dhe në rrugëtimin drejt Evropës. Serbia nuk ka vendosur ende nëse po shkon drejt Evropës apo drejt Rusisë dhe mendoj se vazhdon të mbahet pas Kosovës si diçka që mund ta përdorë për të tërhequr vëmendjen nga pozicioni i saj në Evropë. Kosova ka bërë gjithçka që i është kërkuar nga komuniteti ndërkombëtar, për t'u demokratizuar, për t'u reformuar ekonomikisht, për të qenë një aleatë e mirë e Perëndimit. Ka ardhur koha për amerikanët dhe evropianët që ta mbështesin plotësisht iniciativën politike të Kosovës dhe t'ia bëjnë të ditur Serbisë se tani është koha për të vendosur: Perëndimin apo Lindjen? Nëse Serbia shkon drejt Lindjes, s'ka problem. E shohim se çfarë u ka ndodhur atyre që e kanë ia kanë bashkangjitur të ardhmen e tyre Rusisë. Nuk u ka dalë dhe aq mirë.

Zëri i Amerikës: Nga ana tjetër, disa nga veprimet e qeverisë së Kosovës dhe kryeministrit Albin Kurti janë kritikuar si jokonstruktive, si çështja e dinarit apo më herët ajo e targave, dhe kanë bërë që zyrtarët e lartë amerikanë të shprehin zhgënjim. Mendoni se kritikën dhe paralizimet e tyre se me këto veprime rrezikohet partneriteti, janë të justifikuar?

Paul Williams: Unë e shoh nga perspektiva e ligjit ndërkombëtar. Janë 216 vende në mbarë globin. Kosova është një ndër to. Cilat janë të drejtat, privilegjet dhe detyrimet e tyre? Janë sovraniteti, integriteti territorial dhe pavarësia politike. Nga pikëpamja ligjore, qeveria e Kosovës ka të drejtën e plotë të vendosë se cilat monedha janë të pranueshme, brenda juridiksionit të saj. Sigurisht që mundet ta bëjë këtë në një mënyrë të rafinuar, por është krejtësisht e arsyeshme t'u kërkojë shtetasve në territorin tënd që të përdorin targa të tua, të përdorin monedhën tënde dhe të zbatojnë ligjet e vendit tënd. Dhe nuk është krejtësisht e përshtatshme për evropianët dhe amerikanët që të mpakin disi sovranitetin e Kosovës, duke thënë se 'në 90% të territorit tënd, për 95% të popullsisë tënde, rregullat vlejnë, por ka një përjashtim për këtë territorin tjetër'. E kemi parë se çfarë ka ndodhur në Bosnjë, me Republikën Srpska. Çfarëdolloj pran-



imi i interesave të Republikës Srpska sjell më shumë ndasi dhe përçarje brenda Bosnjës. Mendoj se Kosova është shumë e mençur që mendon se 'nuk na duhet një Republikë Srpska në Kosovë, na duhet një vend i plotë'. Duhet ta keni parasysh se unë nuk do t'i thoja këto nëse Kosova nuk do të kishte bërë përparimin që ka bërë për shtetin ligjor, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe demokracinë. Nëse do të kishte një tjetër lloj regjimi, atëherë mund të kishte ndonjë pikëpyetje për këtë, por në 25 vite Kosova ka bërë përparim të rëndësishëm, sipas standardeve që ne në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropën Perëndimore përdorim për të vlerësuar vendet.

Zëri i Amerikës: Argumentet e tyre janë se ka disa veprime që mund të shmangen për të mos përqesuar një proces që ata mendojnë se mund të arrijë rezultat. Si do t'u përgjigjeshit këtyre argumentave?

Paul Williams: Mendoj se fatkeqësisht një ndër kapitujt kryesorë në librin e rregullave diplomatike është akomodimi i agresorit. Në këtë rast, Serbia ishte një agresore ushtarakisht një çerek shekulli më parë, por edhe agresore politike. Pa dashur t'i ngatërojë gjërat, por ne e pamë se çfarë ndodhi në vitin 2014 kur Perëndimi akomodoi aktivitetet dhe agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës dhe solli luftën që kemi tani. Nuk jma dakord me nocionin që pala më e dobët, ose aleati apo miku ynë, të mos i përgjigjet provokimeve të shtetit agresor. Mendoj se kemi mësuar se kur një vend përpiket të ngacmojë një vend tjetër, jo vetëm që ky i fundit duhet të mbrojtë të drejtat dhe privilegjet e tij, por atë duhet ta mbështesin edhe aleatët, dhe jo të përpiqen të minimizojnë reagimin e tij. Mendoj se i kemi parë pasojat, kur nuk i kemi mbështetur aleatët kur i janë kundërvënë agresionit politik, apo edhe agresionit ushtarak. Dhe këto pasoja nuk janë të mira.

Zëri i Amerikës: Por ju keni ndërm-

jetësuar negociata mes palëve në vende të ndryshme për një kohë të gjatë. A nuk janë fleksibiliteti dhe lëshimet nga të dyja palët, një nga elementët për sukses?

Paul Williams: Nëse palët negociojnë me vullnet të mirë dhe përpiqen t'u përgjigjen interesave të njëri-tjetrit, atëherë po, njëra palë nga një pozicion, pala tjetër ka një pozicion të saj. Japin dhe marrin për të mësuar se si mund të plotësohen interesat e tyre. Por, kjo është një përjasje tradicionale për negociata tregtare, apo negociata ku miq dhe aleatë kanë një mosmarrëveshje. Në këtë situatë, Serbia nuk ka pranuar se si rezultat i krimeve të saj mizore, Kosova, tashmë e veçuar nga Serbia, u bë një vend i pavarur dhe që njihet nga Perëndimi. Dhe se ka një numër serbësh që jetojnë në Kosovë dhe që janë shtetas të Kosovës. Ata nuk janë shtetas të Republikës së Serbisë. Kosovës nuk i duhet bërë asnjë lloj presioni që të shkëpusë shtetasit serbë të Kosovës nga shteti i Kosovës.

Zëri i Amerikës: Një nga çështjet më të mprehta, nëse jo më e mprehta është Asociacioni i Komunave Serbe, për të cilin Perëndimi, SHBA dhe BE thonë se Kosova nuk po tregon gatishmëri për ta zbatuar, megjithëse ka nënshkruar marrëveshje. Kosova druhet se zbatimi i saj do sillte përsëritjen e një skenari si ai i Bosnjës. Si e shihni ju këtë çështje?

Paul Williams: Mendoj se Kosova ka nxjerrë mësim nga historia. Kur ne punojmë me klientët tanë për negociatën, ne gjithmonë flasim për krashime me praktike të ngjashme shtetërore, për çfarë u ka ndodhur vendeve të tjera. Kosovës i duhet t'i hedhë sytë vetëm 100 milje pranë për të parë se çfarë ka ndodhur me Marrëveshjet e Dejtonit. Në teori, marrëveshjet ishin ndërtuar për të bashkuar Bosnjën. Presidenti Milosheviç dhe të tjerë këmbëngulnin për një Republikë Srpska, dhe ishte një lloj përjasje e butë, në mënyrë që

anëtarët serbë të Bosnjës të kishin komunitetin e tyre dhe një grupim. Ata e kanë përdorur këtë për të dëmtuar sovranitetin dhe sinqerisht integritetin territorial të Bosnjës për këto 25 vjet e fundit. Pra, Kosova i shikon këto dhe ka shumë dyshime për këtë asociacion, se mund të jetë një kalë troje. Në teori, tingëllon mirë, dhe nëse komuniteti ndërkombëtar do të kishte shprehur angazhimin për ta mbajtur si një asociacion, ku do të kishte koordinim për arsimin, kulturën, gjuhën, si një bashkëpunim financiar, atëherë do të ishte në rregull. Por shpesh shitet si një përjasje e butë, se është një koordinim, se është një asociacion. Dhe realisht shndërrohet në një entitet politik, që mund të përdoret për të dëmtuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Pra Kosova ka rënë dakord për asociacionin, por u nevojiten garanci të hekurta se nuk do të përdoret për të dëmtuar sovranitetin e saj. Mund të thoni që t'i besojmë fjalës së Serbisë, por kemi Bosnjën si një shembull të asaj që kanë bërë me këtë lloj asociacioni, apo identiteti politik.

Zëri i Amerikës: Shtetet e Bashkuara kanë thënë se Asociacioni nuk do të cenonte integritetin dhe autoritetin e Kosovës dhe do të ishte në përputhje me Kushtetutën e saj. Pse të mos pranohet një garanci e tillë?

Paul Williams: Në teori ndoshta nuk do ta cënonte, por në realitet, dhe bazuar në praktika të mëparshme shtetërore, mund të shfrytëzohej si një platformë, nëse nuk do të ishin këto garanci të hekurta. Unë isha me boshnjakët si këshilltar i tyre në Dejton dhe më pas me kosovarët si këshilltar i tyre në Rambuje dhe dëgjua versionin se Republika Srpska, Federata do të funksiononin. Se ishin thjesht të përkohshme. Se na duhej ta rindëtonim dhe bashkonim Bosnjën. Por, e kemi parë se si ka dalë realisht në praktikë. Pra fjalët në letër mund të duken në rregull, por është e rëndësishme të jesh shumë skeptik. Sërish mund të shkohet përpara me asociacionin, por mund të ketë dokumente të tjera qartësimi ose deklarimi të synimeve. Nuk ka asnjë arsye përse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian të thonë se, nëse kjo është e padëmshme, mund të bëjnë një marrëveshje dypalëshe me Kosovën, ku të artikullohet qartazi botëkuptimi i Shteteve të Bashkuara i kësaj marrëveshjeje për asociacionin, apo i evropianëve, dhe që i angazhon Shtetet e Bashkuara për ndërmarrjen e masave të caktuara, në rast se nuk do të zhvillohet ashtu siç është thënë.

Zëri i Amerikës: Nga ana tjetër, Presidenti Aleksandar Vučić nuk po i plotëson detyrimet e palës serbe. Treguesi më i fundit është përpjekja

IRENA BEQIRAJ

PUSHTETI QË ZBULON TË PRISHURIT QË NË VEZË!

Në fund të viteve 1930, një burrë që sapo kishte mbaruar fakultetin juridik po gjykonte çështjen e tij të parë kur gjykatësi e kërcënoi se do ta përjashtonte: “Kam dyshime serioze nëse i keni kualifikimet e nevojshme etike për të praktikuar drejtësinë”, i tha gjyqtari avokatit. Emri i avokatit ishte Richard Nixon.

Në atë kohë, Nixon pranoi se kishte ndërmarrë veprime të dyshimta pa autoritetin e klientit të tij. Pushteti nuk e transformoi atë; Kur u bë president njerëzit kuptuan më shumë se kush ishte ai.

Konsideroni një avokat tjetër, Lincoln. Të qenit president zbuloi tek ai më të mirën. Siç thotë biografi i Linkolnit, Robert Green Ingersoll: “Asgjë nuk zbulon karakterin e vërtetë të njeriut sesa përdorimi i pushtetit. Nëse dëshironi të dini se



çfarë është në të vërtetë një njeri, jepini atij pushtet”.

Megjithëse për dekada, psikologët ishin të bindur se pushteti korrupton karakteret njerëzore, rezultatet e eksperimentit klasik të burgut të Stanfordit, ku studentët caktoheshin rastë-

sisht për të luajtur rolin e të burgosurve ose rojeve të burgut ishin tronditëse. Studentët gardianë përfunduan duke u hequr rrobat e të burgosurve dhe duke i detyruar shokët e tyre të flinin në dysheme betoni.

“Në vetëm pak ditë, rojet tona u bënë

sadistë”, tha psikologu Philip Zimbardo.

Përtej rezultateve një detaj tjetër ishte edhe më kritik: karakteristikat e studentëve që u paraqitën për të marrë pjesë në “eksperimentin e jetës së burgut”. Vullnetarët që u paraqitën për studimin e burgut kishin prirje 26 për qind më të larta për agresion, 12 për qind më të shumë si narcisiztë dhe shfaqnin 10 për qind më të shumë prirje autokratike dhe makiaveliste sesa njerëzit që regjistroheshin si vullnetarë në studime të tjera psikologjike që nuk kishin lidhje me pushtetin.

Natyrë e njerëzve që dëshirojnë pushtetin, edhe mënyra sesi ata do ta përdorin, nuk duhet të na surprizojë, ajo përcaktohet qartësisht nga identitetet e tyre para se të vijin në pushtet.

“Pushteti nuk transformon ose korrupton gjithmonë,” ka thënë autori

Robert Caro, duke reflektuar mbi Lyndon B. Johnson. “Pushteti gjithmonë zbulon. PUSHTETI i mjaftueshëm zbulon atë që njëri është edhe ka dashur gjithmonë të bëjë”.

E pra, “alibia se njerëzit korruptohen apo transformohen sapo vijnë në pushtet, apo siç thotë kryeministri se “Karrigia e pushtetit është një kafshë e egër që po e le të të hyjë në trup, të mbush xhepin por të merr mendjen”, është një gënjeshtër shfaqësuese për të fshehur mekatin, që ato që vendosen e mbahen në karriket e pushtetit me kast janë zgjedhur të tillë “të prishur që në vezë”.

Pushteti nuk e shndërron delen në ujë, pulën në dhelprë, e kalin në gomar! Lulëzimi i ujëqerve, dhelprave edhe gomerëve nuk mund të justifikohet me trasformimin që ato pësojnë në pushtet!

për të bërë gjithçka për të penguar anëtarësimin e Kosovës në Këshillin Evropian, megjithëse sipas marrëveshjeve të vitit të kaluar, të dyja palët nuk duhet të pengojnë integrimin e njëra-tjetrës. Si do t'i karakterizoni këto veprime?

Paul Williams: Mendoj se këto veprime heqin të gjitha dyshimet apo paqartësitë për përfaqshen e Serbisë ndaj Kosovës. Këshilli i Evropës ofron mundësinë që popullsia e Kosovës, qofshin shqiptarë apo serbë, apo të tjerë, të mund të sjellin çështjet e tyre të drejtave të njeriut tek Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Është një mënyrë për të qenë pjesë e komunitetit evropian të vendeve, pra vendeve të tjera që janë të përkushtuara ndaj demokracisë dhe shtetit ligjor. Pra lind pikëpyetja se përse Serbia kundërshton praninë e Kosovës në Këshillin e Evropës, që në fakt do të ndihmonte për të mbështetur dhe mbrojtur të drejtat e njeriut të popullsisë serbe në Kosovë. Serbia është thjesht e interesuar që t'i kundërvihet Kosovës dhe të gjejë mënyra për të dëmtuar pavarësinë e saj politike, dhe ka ardhur koha për evropianët dhe amerikanët ta kuptojnë bllofin e Serbisë dhe ta marrin seriozisht zgjidhjen e kësaj çështjeje mes Serbisë dhe Kosovës.

Zëri i Amerikës: Trysnia e shtuar për të zgjidhur këtë çështje, nuk mund të shihet jashtë kontekstut të luftës në Ukrainë dhe përpjekjeve që Serbia të mos rreshtohet krah Rusisë por të shikojë nga Perëndimi, apo jo?

Paul Williams: Perëndimi është përpjekur tashmë prej tre dekadash për ta tërhequr Serbinë brenda kampit perëndimor. Serbisë i duhet Perëndimi. Perëndimit nuk i duhet Serbia. Serbia e shikon të ardhmen e saj, dhe ka qenë gjithnjë e qartë për

këtë, të lidhur me Rusinë. Dhe nëse e shikoni statusin e Rusisë, për momentin po humbasin ose janë në ngërç përballë një vendi që ka qenë ish-republikë e Bashkimit Sovjetik dhe është sa një çereku i përmasave të saj, ka një të katërtën e prodhimit të saj ekonomik. Rusia është realisht një tigër prej letre. E ardhmja e Evropës, lindje apo perëndim sido që të dëshironi ta përkufizoni, nuk gjendet në duart e Rusisë. Është në duart e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara. Nëse Amerika dëshiron të ngrejë shpatullat dhe ta lërë Serbinë të ndjekë fatin e saj, kjo është në rregull. Ajo çfarë kemi mësuar nga konflikti në Ukrainë është se duhet të investohemi edhe më shumë tek marrëdhëniet me aleatët tanë, pasi kështu mund të kemi ndikim tek rendi global dhe ta mbajmë botën të sigurtë, jo duke akomoduar dhe kënaqur armiqët, apo ata që janë të pavendosur, si Serbia.

Zëri i Amerikës: Presidenti Vladimir Putin ka paraqitur si precedent ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, duke vendosur një paralele mes tij dhe agresionit rus në Ukrainë. Si e shihni këtë retorikë?

Paul Williams: Putini ka një histori të gjatë të shtrembërimit të historisë, ligjit dhe precedentëve. Serbia kishte kryer krime mizore në Kroaci, kishte kryer krime mizore dhe gjenocid në Bosnje dhe po kryente krime mizore në Kosovë. Zgjidhja e Kroacisë, Bosnjës dhe Kosovës ishte pavarësia. Nëse je pjesë e një territori, një vendi që po përpiket të vrasë njerëzit e vet, ke të drejtën të shkëputesh dhe të bëhesh i pavarur, për të mbrojtur popullin tuaj. Asnjë nga këto fakte nuk vlen për situatën e Ukrainës. Ukraina ishte demokratike, e bazuar në shtetin ligjor, me orientim evropian. Putini thjesht nuk donte që Ukraina të rresh-

tohej në krah të Perëndimit dhe kështu ai vendosi që fillimisht të të merrte një pjesë të territorit Krimenë dhe Donbasin. Perëndimi nuk bëri asgjë dhe ai vendosi të hyjë për të marrë gjithçka. Fatmirësisht, ukrainasit iu kundërvunë, në këtë rast të mbështetur nga amerikanët dhe evropianët, dhe ata kanë qenë në gjendje ta ndalin dhe në një farë mase ta frenojnë atë agresion, por nuk ka asnjë paralele mes asaj që bëri komuniteti ndërkombëtar për të mbrojtur popullin e Kosovës nga Serbia, që mund të thuash që ishte një regjim gjenocidal, bazuar tek ajo që kishin bërë në Bosnje. Nuk ka krahasim me atë që po bën Rusia. Përkundrazi, siç po e shohim me akt-padinë ndaj Putinit në Gjykatën Ndërkombëtare Penale, rusët kanë kryer krime, mizori kundër popullit të Ukrainës. Pra, ata janë më shumë në pozitën që ishte Serbia.

Zëri i Amerikës: Presidenti Vuçiç po përpiket gjithashtu të ndalojë një rezolutë të OKB-së muajin e ardhshëm, që do ta quante gjenocid atë që bëri Serbia në Bosnjë. Si e shihni këtë përpjekje të tij për një dokument që nuk do të kishte fuqi detyruese?

Paul Williams: Sepse politikën që ndoqi Millosheviçi, dhe agresioni territorial në Kroaci, gjenocidi kundër Bosnjës dhe krimet mizore ndaj Kosovës, kanë ende gjurmë të thella në qeverinë e Vuçiçit. Nëse do të kishte pasur një tranzicion të vërtetë demokratik, po të kishte ndodhur një transformim i regjimit serb, pushtetit serb, atëherë nuk do t'i shqetësonte një nismë e tillë. Shumë vende që kanë qenë në situata ku udhëheqësit e mëparshëm kanë kryer krime mizore ose gjenocid janë të gatshëm ta pranojnë atë dhe të gatshëm të thonë po, kjo është e kaluara. Tani kemi kthyer

një faqe dhe jemi një qeveri e re. Por Serbia ende nuk është shkëputur nga perioda e Millosheviçit. Dhe kjo është arsyeja pse janë shumë kundër njohjes së faktit që regjimi i Millosheviçit kreu gjenocid në Bosnje, dhe mendoj se është e rëndësishme që vendim-marrësit e sotëm të jenë të vetëdijshëm për këtë. Nëse ata ndjekin të njëjtin skenar të akomodimit si 30 vjet më parë dhe u bëjnë presion miqve dhe aleatëve tanë, do të kenë të njëjtat rezultate, do të kenë një proces të dështuar.


Zëri i Amerikës: Kanë kaluar 25 vjet nga ndërhyrja e udhëhequr nga NATO-ja në Kosovë për shkak të kundërshtimit nga ana e Millosheviçit që të nënshkruante një marrëveshje që do t'i jepte autonomi Kosovës. Si dikush që ishte i përfshirë në negociatat e Rambujesë, si e shihni sot atë vendim dhe si e shihni situatën sot?

Paul Williams: Sot flasim për marrëveshjen për asocacionin, bojkotim zgjedhesh dhe targat e makinave. Mendoj se nëse shkëputemi pak dhe shohim se ku ishte situata 25 vite më parë, ishte shumë e tmerrshme për popullin e Kosovës. Ishte shumë e tmerrshme për sigurinë në Evropë. Bashkimi Evropian mezi ia doli mbanë gjatë luftës në Bosnjë; OKB-ja u delegjitimua me dështimin e misionit UNPROFOR, forcat mbrojtëse të OKB-së në Bosnjë, dhe 2 milionë njerëzit e Kosovës shumë prej të cilëve ishin dëbuar, zhvendosur, rrezikonin vërtet të zhdukeshin si popull. NATO filloi një ndërhyrje humanitare, që ishte veprimi i duhur. Iu kundërvu regjimit të Millosheviçit, për t'i thënë në thelb ‘Jo. Do ta caktojmë më në fund vijën. Nuk mundesh t'i bësh këto mizori’. Dhe e vendosën Kosovën në rrugëtimin drejt pavarësisë dhe u njoh nga mbi 100 vende.

Dhe ç'është më e rëndësishme, Kosova ka patur tranzicione paqësore demokratike, çdo herë që janë mbajtur zgjedhje. Është kaluar nga një parti tek tjetra dhe kështu me radhë. Tranzicionet drejt demokracisë janë të vështira, por Kosova e ka realizuar këtë tranzicion. Pra askush në Shtetet e Bashkuara nuk mundet të hedhë vështrimin pas dhe të thotë se ndoshta nuk duhej të ishim përfshirë politikisht, ndoshta nuk duhej ta kishim bërë ndërhyrjen humanitare. Pra sinqerisht, duke lënë mënjanë çështjet e përditshme, pamja e përgjithshme është se ky është një sukses i jashtëzakonshëm për të gjithë popullin e Kosovës të cilëve iu kursyen mizoritë dhe për të gjithë fëmijët e tyre dhe brezat e ardhshëm. Si dhe për Shtetet e Bashkuara që të kenë kuptuar vlerën e një mesimi të nxjerrë nga një ndërhyrje humanitare, dhe të mbështetjes për aleatët dhe miqtë. Do të përmendja edhe diçka tjetër, nëse na e lejon koha, se popullit të Kosovës i takon respekt i jashtëzakonshëm për atë çfarë kanë arritur. Nëse shikoni 20 vitet e fundit, si patur disa vende të tjera, si Iraku dhe Afganistani, ose shikoni Libinë, ku komuniteti ndërkombëtar hyri dhe ofroi hapësirat që njerëzit të ndërmerin një transformim demokratik. Dhe ata e shpërdoruan këtë. Nuk kanë bërë çfarë nevojitet për të patur paqe, siguri, demokraci dhe shtet ligjor. Nuk është e lehtë. Pra pavarësisht nga shqetësimet e përditshme që mund të kenë eksistuar në këto 25 vite, është një moment i mirë për të kuptuar se jo vetëm shpëtuam veten, jo vetëm që na ndihmuan amerikanët dhe evropianët që të shpëtonim, por kemi patur 25 vite demokraci dhe përparim dhe shtet ligjor. Pra vështirësi të vogla këtu dhe atje, por asgjë krahasuar me vendet e tjera. Vendet e tjera kanë shpërdoruar mundësitë. Kosova nuk e ka shpërdoruar mundësinë.

POROSISNI BUSINESS CARDS

Dotech websites



Websites 01

Business Cards 02

Banners 03

Marketing 04



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

DY SFIDA PRANVERORE TË SERBISË

VETON SURROI

Këshilli i Evropës dhe Rezoluta për Srebrenicën janë testim i Serbisë ndaj qendrueshmërisë së bashkësisë euroatlantike, madje edhe asaj ndërkombëtare. Dhe, këta janë hapa që e largojnë Serbinë tutje prej normalizimit

1.

Serbia është përgatitur ta sfidojë bashkësinë euroatlantike - madje edhe më gjerë atë ndërkombëtare - në javët e ardhshme.

Sipas presidentit Vuçiq, Serbia do të angazhohet kundër anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës dhe kundër aprovimit të Rezolutës së OKB-së lidhur me dënimin e gjenocidit në Srebrenicë. Votimi për anëtarësimin e Kosovës në KiE kalon fazën parapërfundimtare më 16 prill në Asamblesë Parlamentare të KiE, ndërkohë që Draftrrezoluta për dënimin e gjenocidit në Srebrenicë është në konsultim e sipër me shtetet anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së; ende nuk është e caktuar data kur do të mund të votohej për të.

Me këtë Serbia po nis në një shkallë të re të kontestimit të, nëse mund ta quajmë ashtu, rendit ndërkombëtar; apo rendit ndërkombëtar çfarë është deri më sot. Në këtë rend supozohet se Serbia është një shtet kandidat për anëtarësim në BE dhe është shtet i cili i mbetet besnik multilateralizmit të ndërtuar nga OKB-ja.

Por, gjatë muajve prill dhe maj, nëse vazhdon me aktivitete të kontestimit në KiE dhe OKB, Serbia po i konteston BE-në dhe OKB-në.

2.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të duhej të ishte rezultat i natyrshëm i normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Për më tepër, do të duhej të ishte produkt i politikës së BE-së për normalizimin e marrëdhënieve, ashtu siç është përcaktuar në Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të cilën Komisioni Evropian, nëpërmjet nënkryetarit të saj J.Borell, e konsideron ligjërish të obligueshme si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë. Serbia megjithatë konsideron se nuk është e obliguar të respektojë pikën 4



të Marrëveshjes (e as ndonjë pikë tjetër që flet për sovranitetin dhe tërësinë tokësore të Kosovës). Kështu Serbia mund të kontestojë Marrëveshjen, por në thelb është duke kontestuar se ka marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Dhe këtë mund ta bëjë, ngase vetë BE-ja nuk është gjithaq e sigurt se Marrëveshja për rrugën e normalizimit hyn në kategorinë e marrëdhënieve kontraktuale: Komisioni i BE-së ende nuk ka arritur të kryejë obligimin që e kishte marrë në dhjetor të vitit të kaluar që deri në fund të janarit të këtij viti ta integrojë Marrëveshjen e normalizimit si pjesë të obligimeve kontraktuale të Kosovës dhe respektivisht Serbisë me BE-në. Rezoluta për gjenocidin në Srebrenicë do të duhej të ishte pjesë normale e procesit të pajtimit pas luftërave në ish-Jugosllavi. Një vendim që 11 korriku të shënohet në kuvende të shteteve evropiane është miratuar në Parlamentin Evropian dhe shumë shtete evropiane, përfshirë Kosovën, e kanë shënuar. Një iniciativë e këtillë tash po ndërmerret në nivel botëror nga ana e dy bashkësponsorëve të Rezolutës, Ruanda dhe Gjermania. Që të dyja shtetet kanë përvojë të tmerrshme me gjenocidin. Holokausti i Gjermanisë naziste ishte shkak

që pas Luftës së Dytë Botërore fillimisht të sajohet fjala "gjenocid" e pastaj edhe të shndërrohet në term të së drejtës ndërkombëtare. Në Ruandë, para saktësisht tridhjetë vjetësh, u shënuar akti më i tmerrshëm i gjenocidit pas Luftës së Dytë Botërore, me mbi 800 mijë të vrarë, ndërsa shtetet e mëdha dhe OKB-ja vëzhgonin pa vepruar për ta penguar.

Gjermania është sot shembulli më i mirë i ballafaqimit me të kaluarën dhe të ndërtimit të një shoqërie tolerante e demokratike nga një shoqëri totalitare që ishte në gjendje të vraste miliona njerëz. Ruanda për tridhjetë vjet rresht u përpoq të ndërtonte një shoqëri që tejkalohe ndasitë e mëdha mes dy popujve, hutu dhe tutsi, duke ndërtuar një projekt vetjak të ballafaqimit me krimet. Pra, kur këto dy shtete (dhe shumë të tjera që e përkrahin Rezolutën për Srebrenicën) thonë se është koha që bota në tërësi të shënojë 11 korrikun, ditën kur më 1995 u vranë mbi tetë mijë fëmijë e burra boshnjakë-muslimanë, ky duhet të jetë një akt që do të bashkojë edhe popujt e ish-Jugosllavisë rreth aktit më të tmerrshëm të luftërave në atë pjesë të botës.

3.

Por në Serbi, në atë zyrtare dhe në një pjesë të madhe të opozitës, ekziston një bindje tjetër rreth Srebrenicës. Ekziston bindja se atje ndodhi një krim i rëndë, por jo edhe gjenocid, sepse po të kishte ndodhur gjenocidi atëbotë "serbët do të ishin popull gjenocidal". Rrjedhimisht, Republika Serbe në BeH do të ishte prodhim i gjenocidit.

Mbase ky do të ishte shembulli më i mirë i procesit nëpërmjet të cilit po kalon ligjërimit publik në Serbi, e fjala është për adaptimin e realitetit paragjykimave politike. Edhe pse gjenocidi në Srebrenicë është tashmë i konstatuar juridikisht - Radovan Karaxhiqi dhe Ratko Mladiqi janë dënuar për këto vepra dhe po mbajnë burg deri në ditët e fundit të jetëve të tyre për këtë - ligjërimit serb po përpigjet ta mohojë këtë duke vënë përpara jo fakte që do të mohonin ekzistencën e gjenocidit në Srebrenicë, por arsyetimin se përse Serbisë nuk i konvenon që kjo të jetë e vërtetë.

Rrjedhimisht ky shndërrohet në parim të ligjërimit në Serbi: realiteti duhet

t'i adaptohet projeksonit të ligjërimit serb. Kjo shihet edhe në rastin e Kosovës: Serbia është në rrugën evropiane, e pranon planin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, por Kosova nuk mund të jetë anëtare e Këshillit të Evropës, sepse, sipas paragjykimit serb, Kosova nuk është shtet dhe meqë paragjykimi serb është se Kosova nuk është shtet, realiteti i tërë kontinentit evropian duhet t'i adaptohet këtij paragjykimi.

4.

Sfida së cilës i ka hyrë Serbia në OKB mund të jetë një autogol i madh politik. Ligjërimit i Serbisë gjatë këtij shekulli ka qenë se ky vend u qëndron besnik të drejtës ndërkombëtare dhe OKB-së, ndërkohë që njëkohësisht po ky vend po përpigjet të mohojë atë që e drejta ndërkombëtare dhe një institucion i krijuar prej Këshillit të Sigurimit të OKB-së, pra Tribunali Ndërkombëtar për Krime në ish-Jugosllavi, ka konstatuar - se në Srebrenicë është kryer gjenocidi.


Ndoshta ky autogol mund të jetë i përllogaritur si pjesë e një lëvizjeje që tregon se Serbia është e gatshme ta bëjë edhe këtë - pra ta sfidojë një realitet të mirëqenë e të vërtetuar, siç është gjenocidi në Srebrenicë. Dhe se bashkësia ndërkombëtare për ta akomoduar Serbinë brenda saj duhet të jetë më e mirëkuptueshme për brengat e tjera të saj, për shembull në Kosovë.

Ky cikël i sfidimit të realitetit nuk është i ri. Në një analogji që tash duket e largët, ky sfidim ka ndodhur në një periudhë tjetër të zhvillimeve tektonike në kontinentin evropian; Slobodan Milosheviqi e kishte bërë këtë pasi kishte rënë Muri i Berlinit. Ndërsa e tërë Evropa hiqte dorë prej komunizmit dhe përqafonte lirinë e tregut dhe të drejtën e konkurrencës shumëpartiake e liritë e tjera politike, Serbia e tij avokonte për një "pluralizëm njëpartiak", si demokraci e vetme autentike. Prapa këtij avokimi fshihej një përllogaritje e thjeshtë: në demokraci, ku sundon shumica e fituar në vota, në Kosovë do të sundonin ata që nuk pajtohen me nënshtrim të Serbisë. E tëra pastaj është histori dhe e përgjakshme.

Momenti nëpër të cilin po kalon kontinenti evropian është sërish tektonik, me luftën e Rusisë kundër Ukrainës dhe përpjekjen për vendosjen e një rendi të ri evropian e botëror. Sfidat e Serbisë - rreth KiE dhe Srebrenicës - do lexuar brenda këtij konteksti. Për fat të keq, janë hapa që e largojnë Serbinë prej idesë së normalizimit, qoftë të raporteve brenda regjionit të Ballkanit Perëndimor, qoftë të regjionit me BE-në.

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Temperature
- Pulse
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në Google?

Dotech
website 

Our Services:

- Business Cards
- Logos
- Banners
- Video Marketing

PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TË VINI NË ZYRAT TONA

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**